



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.01.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektvendim “Për miratimin e kërkesës së Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për marrjen e opinionit të Komisionit të Venecias për tekstin e rishikuar të projekt – amendamenteve kushtetuese të propozuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, mbështetur në Raportin e ndërmjetëm të Komisionit të Venecias”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Spartak Braho, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Jorida Tabaku, Vexhi Mucmata dhe Silva Caka

Të ftuar:

Z.Rainer Deville – Shef i Misionit Euralius, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Jon Smibert – Këshilltar Ligjor Rezident, OPDAT, Ambasada e ShBA-së, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Kristaq Traja – Koordinator i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë

Z.Sokol Sadushi - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Gent Ibrahimimi - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Znj.Aurela Anastasi – Eksperte e Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Mund ta fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Kuorumi plotësohet, kështu që mund të vazhdojmë normalisht të procedojmë sipas Rregullores. Kemi këtu përfaqësuesit e Nënkomisionit për Çështjet e Reformës Kushtetuese, autorët e projektit kushtetues që kemi në tavolinë. Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë ka paraqitur pranë këtij komisioni këtë dokument së bashku me relacionin përkatës. Ashtu siç veprojmë normalisht me çdo procedurë parlamentare për zhvillimin e mbledhjeve të komisionit, fillimisht do të dëgjojmë autorët e dokumentit, të cilët do të bëjnë një paraqitje të shkurtër, koncize, të përmbledhur të projektit që të vazhdojmë më pas me debatin parlamentar.

Fjalën e ka zoti Sadushi.

Sokol Sadushi – Përshëndetje!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi,

Në cilësinë e bashkëkryetarit të Nënkomisionit për Reformën Kushtetuese do të përpiqem të jem i strukturuar në ekspozenë që dua të bëj para jush lidhur me draftin që kemi përparitur për amendamentet kushtetuese. Ky draft është përparitur mbi bazën e rekomandimeve që opinionin e Komisionit të Venecias ka përparitur për Shqipërinë. Ky opinion është tepër serioz, tepër objektiv dhe tepër konciz, si dhe evidenton vlerat e draftit që kemi paraqitur në atë komision. Ndërkohë, bën edhe kritika dhe sugjeron gjetjen e zgjidhjeve që u përshtaten standardeve ndërkombëtare. Në mënyrë të përmbledhur, duke iu referuar përfundimeve që vetë opinionin e Komisionit të Venecias evidenton qartësisht lidhur me rishikimin dhe thjeshtimin e skemës institucionale, e kemi ndjekur këtë orientim dhe kemi shkuar drejt asaj që ky komision sugjeron, pra për një thjeshtim të skemës. Kjo nuk duhet kuptuar si një fshirje institucionale, sepse kjo gjë do të krijonte një lloj deformimi në të gjithë strukturën kushtetuese që ne kemi sugjeruar të ngremë. Thjeshtimi ka të bëjë më tepër me mënyrën e bashkëpunimit institucional, me një lloj zhdërvjelltësie që do të kenë institucionet kushtetuese që ngrihen në përbërje dhe në kompetenca. Në këtë aspekt mendojmë se kemi shkuar te një thjeshtim, ashtu siç thotë edhe

“Venecia”. Nëse do të ketë pyetje, do ta shpjegoj unë ose do ta shpjegojnë në mënyrë më konkrete kolegët.

Kemi ndryshuar çështjen e inspektorit, pra nga Inspektorat i Lartë është bërë inspektor, si edhe disa çështje që kanë të bëjnë me Tribunalin në drejtim të kompetencave dhe të përbërjes së Këshillit të Emërimeve, ashtu siç kemi shtyrë edhe hyrjen në fuqi të Gjykatës së Lartë Administrative. Nuk po hyj më tepër në detaje, sepse nuk dua t’ju marr më shumë kohë.

Lidhur me çështjen tjetër që ngre Komisioni i Venecias për ngushtimin e aneksit, që, në fakt, është një vërejtje shumë e saktë, ne jemi përpjekur të orientohemi pikërisht mbi atë që thotë ajo. Ne e kemi strukturuar në mënyrë koncize, duke qëndruar kryesisht te ngritja e këtyre institucioneve të përkohshme, te kompetencat që ato kanë, te përbërja dhe të mënyra e organizimit.

Lidhur me Gjykatën Kushtetuese, janë evidentuar të gjitha rekomandimet që ata kanë bërë. Në mënyrë të veçantë është evidentuar çështja që lidhet me mundësinë apo pamundësinë e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar amendamentet kushtetuese, për të cilën është zhvilluar një debat i drejtë. Ne kemi bërë pikërisht atë që ka sugjeruar Komisioni i Venecias për të hyrë në dispozitat, të paktën vetëm në aspektin procedural të këtyre amendamenteve kushtetuese. Gjithashtu, kemi evidentuar çështjen e përgjegjësisë disiplinore që duhet të kenë gjyqtarët kushtetues, që është një përgjegjësi e cila do të kontrollohet apo do të shqyrtohet nga vetë Gjykata Kushtetuese. Kjo vërejtje ka gjetur vend në draft.

Lidhur me rolin e Ministrisë së Drejtësisë, që ka qenë edhe pika më kritike që ka sugjeruar Komisioni i Venecias, në këtë drejtim ne kemi shmangur atë që ka thënë “Venecia” për konfliktin e interesit lidhur me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë në Tribunal apo në Këshillin e Emërimeve. Ndërkohë, kemi mbetur te fakti, dhe jemi të bindur për këtë, ashtu siç thotë edhe Komisioni i Venecias, që Ministri i Drejtësisë duhet ta ketë procedimin disiplinor, por nuk do të ketë ekskluzivitetin e tij, por nëpërmjet inspektorit. Kemi rekomanduar edhe disa aspekte që lidhen me rolin e Ministrit të Drejtësisë, që shkojnë drejt një pozicioni më të qartë në drejtim të gjyqësorit.

Në aspektin e kriterëve, një pikë me vend, për të cilën ka insistuar “Venecia”, është përzgjedhja e gjyqtarëve, duke filluar nga ata të nivelit të ulët deri në Gjykatën e Lartë dhe në atë Kushtetuese. E rëndësishme është edhe procedura që duhet ndjekur. Në fakt, jemi treguar rigorozë në evidentimin e këtij aspekti, sepse është shumë e nevojshme të ketë rregulla të qarta

lidhur me një procedurë gjithëpërfshirëse, transparente dhe me kritere tepër të sakta për sa i përket zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat respektive.

Lidhur me pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Strukturës së Posaçme për Veprat Antikorrupsion, kemi përcaktuar një marrëdhënie më të qartë, e cila ndoshta në draftin e parë mund të mos ishte shumë e qartë. Ndërkohë, mekanizmi zgjidhës për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm ka gjetur vend në Kushtetutë.

Për sa i përket çështjes së *Vetting*-ut, të vlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, shqetësimi i Komisionit të Venecias qoftë në mënyrën e formatimit të aneksit, qoftë edhe në mënyrën e funksionimit të këtyre organeve që kanë të bëjnë me dhënien e mundësisë për një organ që rrezaton pavarësi, paanshmëri, që garanton të drejtat procedurale të palëve, pra që garanton procesin e rregullt ligjor, mundësinë e ankimimit në një gjykatë. Këtu ne kemi thirrur në ndihmë të gjithë jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut lidhur me konceptin e një gjykate apo të një kuazi gjykate. Mendojmë se kemi gjetur një zgjidhje që përshtatet me atë që ka sugjeruar opinionin i Komisionit të Venecias në rekomandimin e tij.

Edhe për sa i përket statusit dhe kushteve të emërimit të vëzhguesve ndërkombëtarë, që kërkohet të jenë më të sakta dhe më precize, ne kemi reflektuar mbi atë opinion që thotë Komisioni i Venecias.

Nuk e di se sa i strukturuar isha dhe nuk e di nëse isha në gjendje që brenda këtij minutazhi të përshkruaja atë që kemi bërë, por, meqenëse ju e keni draftin përpara dhe e keni parë, mendoj se arrita të parashtoj ato që ishin pikat kryesore në këtë opinion 30 faqesh të Komisionit të Venecias të përbërë nga 138 pika për draftin kushtetues që kemi përgatitur. Nëse ju keni pyetje, të gjithë kolegët janë të gatshëm për të dhënë përgjigje.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – A ka ndonjë nga përfaqësuesit e tjerë të ekspertëve për të thënë diçka?

Jon Smibert – (*flet anglisht*)

Do të bëja një koment për përkthimin e nenit 179, për paragrafin 9, i cili është i saktë në versionin anglisht, por nuk është i saktë në versionin shqip. Ne e kemi korrigjuar dhe e kemi printuar këtë nen dhe këtë paragraf, që ka të bëjë me transformimin dhe dispozitat transitorë për sa i takon transformimit të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe të Prokurorisë së Krimeve të Rënda në strukturat antikorrupsion.

Fatmir Xhafaj – Besoj se është e qartë me saktësimin e nevojshëm që u bë lidhur me nenin 179 që ka të bëjë me Gjykatën e Krimeve të Rënda, me dispozitën transitorë.

Eduard Halimi – A mund të na e lexoni se si e keni depozituar draftin, pra përkthimin e saktë? Ka një shqetësim në një *email* që kanë marrë të gjithë anëtarët, sigurisht edhe unë bashkë me ta, ku gjyqtarët e Krimeve të Rënda, sipas asaj që shkruhet në shqip, pretendojnë se janë hedhur në rrugë. Ju lutem, na e qartësoni!

Jon Smibert – (*flet anglisht*)

Ka një përkthim në shqip, të cilin ne po e shpërndajmë të printuar tek të gjithë anëtarët, kështu që unë nuk po e lexoj në shqip. Unë kam përpara versionin anglisht të kësaj dispozite, e cila është e gatshme t’i dorëzohet Komisionit të Venecias.

Fatmir Xhafaj – Duke qenë se u shpërnda, materiali është i qartë edhe për kolegët. A ka ndonjë gjë tjetër? Nuk ka.

Vazhdojmë me diskutimet.

Fjalën e ka zoti Halimi.

Eduard Halimi – Së pari, Komisioni duhet të ishte mbledhur në datën 22 dhjetor. Pra, të nesërmen e ditës kur Komisioni i Venecias solli opinionin e tij. Duhet të ishte mbledhur atë ditë. Të ishim ne si komision ata që t’u jepnim detyrën ekspertëve, atyre të emëruar nga ana juaj dhe atyre të emëruar nga ana jonë. Të ulëshin bashkë ekspertët dhe t’ua kërkonim implementimin ne si komision i përbashkët, i krijuar me paritet ndërmjet palëve politike dhe t’u thoshim të merrnin raportin e Komisionit të Venecias, të ulëshin të gjithë ekspertët dhe të pyesnin grupet e interesit dhe hartonin një draft, i cili të respektonte një më një të gjitha rekomandimet e Komisionit të Venecias. Kjo ishte rruga e duhur dhe ky ishte tregues i vullnetit të mirë. Ky duhet të ishte procesi që duhej të ishte bërë, në rast se tek të gjithë ne ekziston një vullnet i mirë për të bërë një draft të reformës kushtetuese, bazuar në standardet e Komisionit të Venecias. Ta kishim marrë raportin këtu dhe ta kishim lexuar, siç e çmonim të gjithë këtu, ne dhe ju, dhe t’i kishim analizuar të gjitha, sepse e vërteta është që Komisioni i Venecias na kapi me presh në duar. Komisioni i Venecias tha se të paktën 15 prej pikave të draftit të mëparshëm bien në kundërshtim të plotë me standardet e Venecias, siç është: kapja politike, çimentimi politik, vetem prezenca e ministrit të Drejtësisë, kapja në lidhje me Komisionin e Kualifikimeve etj. Duhet të kishit dalë këtu dhe të thoshit se Komisioni i Venecias na kapi në flagrancë. Nuk po i hyj se kush është përgjegjësi dhe se si është bërë dhe pse nuk është bërë. Ne duhet t’u kishim

thënë ekspertëve dhe nuk duhet të kishim bërë këtë që u bë, pra të iknim nga procesi. I thirrët ekspertët tuaj dhe u thatë të vinin e të bënin një draft parafabrikat, si ai i 29 dhjetorit. Pikërisht ky duhej të kishte qenë vullneti në përputhje me standardet, pra të uleshim edhe një herë e t'u thoshim ekspertëve: uluni të gjithë dhe bëni atë që duhej bërë, por pyesni edhe grupet e interesit. Nuk duhej ta kishit bërë procesin në mungesë të plotë transparence. A di ndonjëri këtu nga ju se si e hartuan ekspertët, si u ulën dhe ku u ulën ata që bënë draftin parafabrikat? Jo. A e di ndonjëri nga media se si u ulën, si u bë dhe se ku doli drafti parafabrikat dhe kush jua dha detyrën ekspertëve për ta bërë këtë gjë? Detyrat ekspertët i marrin nga ne, se ata nuk vijnë nga Hëna. Nuk u shkrepet atyre në kokë që të shkojnë të konsultohen në kafe dhe të bëjnë një draft. Jo, ata detyrat i marrin nga ne, por nuk e dinim as ne, as grupet e interesit, as media dhe as qytetarët, ndërkohë që ata dolën më 29 dhjetor dhe thanë se kanë një draft. Kjo gjë është bërë në mënyrë permanente dhe tregon vullnetin e keq për të ikur dhe për t'i orientuar politikisht ekspertët. Kjo sigurisht që nuk është mënyra e duhur që të tregojmë vullnetin e mirë për të bërë një draft në përputhje me standardet e Komisionit të Venecias, por është mënyra për t'iu fshehur atij, për t'iu ikur atyre çështjeve dhe për të mos u dhënë përgjigje atyre çështjeve, të cilat kanë qenë shqetësim i opozitës edhe në mbledhjen e kaluar: kapja politike, neni 55, skema politike, skema e gjyqësorit, e cila synon edhe kapjen politike, korporativizmin për të mos dhënë përgjigje. Pra, për t'iu ikur atyre përcaktimeve, e bëjmë në mënyrë të fshehur. Ndaj, do të ishte krejt logjike dhe racionale që, ajo që nuk u bë më 22 dhjetor, të bëhet sot. Ata ekspertët nuk i ka caktuar asnjë prej nesh këtu, sigurisht që ata i ka caktuar kryetari, besoj, që të bëjnë draftin që na lexuan sot. Asnjë nga ne këtu, nga parlamenti nuk ua ka caktuar atë detyrë atyre. Sot ata mund t'i marrin detyrat nga parlamenti dhe të ulen, sepse kohë ka, bashkë me ekspertët e opozitës dhe me përfaqësuesit e grupeve të interesit t'i implementojnë një për një të gjithë rekomandimet e Komisionit të Venecias. Në qoftë se i marrin detyrat vetëm nga maxhoranca, atëherë sigurisht që janë në konflikt interesi, sepse qeveria është gjithmonë në konflikt interesi për të bërë reformën në drejtësi, cilado qeveri qoftë. Ndaj, kjo ishte edhe kërkesa jonë e parë, e cila duhet të shkojë në të njëjtën linjë me rekomandimet e Komisionit të Venecias. Një konsensus sipas "Venecias" arrihet me një draft ku implementohen një më një kërkesat e Komisionit të Venecias. Prandaj, është momenti që të mos fshihemi pas ekspertëve. Në qoftë se nuk e bëjnë ekspertët, mund ta bëjmë ne, sepse pothuajse të gjithë jemi juristë. Mund të ulemi të shkruajmë dhe të ndajmë se kush është për të respektuar standardet e Komisionit të Venecias dhe kush është për t'iu fshehur

standardeve të këtij komisioni. Kush është me Komisionin e Venecias, kërkon një draft i cili do të implementojë një më një 138 rekomandimet e Komisionit të Venecias. Ai që fshihet, ka një qëllim politik dhe po i përdor politikisht ekspertët. Ky është përdorim.

Së dyti, të gjithë kemi rënë dakord, ndaj jemi bashkë në këtë tryezë, se reforma në drejtësi është jetike për vendin. Kur ne ishim në pushtet dhe ju ishit në opozitë, ju nuk uleshit ndonjëherë të flisnit për reformën në drejtësi. E mbani mend ju?! Fshiheshit pas Ndrekos apo pas tjetrit. Kjo tregonte një vullnet të keq dhe ishte një shenjë e keqe për të arritur një konsensus, bazuar në standarde. Ne si opozitë vendosëm të silleshim ndryshe. Nuk i përdorëm votat që t'ju pengonim të uleshim të diskutonim për reformën në drejtësi. Ju thamë që në korrik se donim të bënim një proces që në formë dhe në përmbajtje dhe të kishim si arbitër "Venecian". Ka pasur negociata të gjata në korrik derisa u bindet dhe ratë dakord për Komisionin e Venecias. Madje ka pasur edhe tentativa kur është thënë se i kemi boll ekspertët tanë këtu, se i kemi të mençur dhe nuk ka nevojë. Ata që kanë marrë pjesë në negociata e dinë këtë gjë. Opozita ka këmbëngulur për Komisionin e Venecias dhe pa këtë komision, ne nuk vazhdonim.

Sigurisht, ne jemi këtu për të treguar që kemi një vullnet të mirë për procesin. Vullneti ynë i mirë u demonstrua qartë në korrik, kur kërkuam të hartoni një strategji të përbashkët që të kishte konsensus, bazuar në të gjitha standardet e përcaktuara nga Komisioni i Venecias. Vullneti ynë i mirë u tregua kur ne paraqitëm në shtator mbi 300 rekomandime konkrete për një strategji për të luftuar korrupsionin, korporativizmin brenda sistemit të drejtësisë dhe kapjen politike të sistemit. Ky ishte një impakt konkret i vullnetit të mirë dhe këto janë fakte, që të paktën publiku i di shumë mirë. Cila ishte përgjigja ndaj këtij vullneti të mirë të opozitës? Ishte e njëjtë si kjo: hartimi i njëanshëm i një drafti në gusht, pa u marrë fare mendimi i anëtarëve të komisionit, por duke u dhënë detyrë ekspertëve të merrnin dhe të bënin një draft në mënyrë të njëanshme. Janë fakte edhe këto. Kjo ishte shenja e parë e vullnetit të keq të treguar nga maxhoranca për të prishur konsensusin dhe për të ndërtuar një draft që të anashkalonte grupet e interesit pa transparencë, por edhe ekspertët e opozitës. Kemi pasur 5 orë debat për këtë herën e kaluar dhe nuk dua që t'i përsëris. Shkuam në Venecia.

Duhet t'i bëjmë disa gjëra të qarta këtu, larg retorikës së selive të partive politike. Drafti i përgatitur nga ju, në përmbajtje ka tre komponentë:

Ka komponentët e krijimit të mekanizmave për të luftuar korrupsionin në radhët e funksionarëve të lartë, dhe këtë gjë ne e kemi diskutuar edhe me ekspertët ndërkombëtarë,

krijimin e SPAK-ut, e gjykatave speciale, prokurive speciale, kishte krijimin e byrosë, dhe e ka sërish, por me ligj dytësor, dhe me radhë. A kemi pasur ne ndonjë ditë të vetme kundërshtime rreth krijimit të këtyre mekanizmave, që luftonin korrupsionin në radhët e zyrtarëve të lartë? Ja ku janë të gjithë ekspertët e huaj, sepse tek ata kam më shumë besim. Zero, asnjë ditë. Pse? Sepse ato institucione krijohen, në radhë të parë, për të luftuar korrupsionin në qeveri. Pse? Sepse qeveria ka mundësi të bëjë tendera, të bëjë korrupsion, të marrë para, ndaj edhe opozita është e painteresuar që ta bëjë një gjë të tillë në mënyrë të padiskutueshme, ndaj dhe e kemi mbështetur deri më sot.

Drafti, komponenti i dytë, ka pasur të bëjë me luftën kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor, Vetting-un, kontrollin e pasurive të gjyqtarëve, integritetin, krijimin e strukturave të posaçme për luftën kundër korrupsionit në drejtësi. A kemi pasur ne ndonjë kundërshtim lidhur me krijimin e këtyre mekanizmave, që luftonin korrupsionin në sistemin e drejtësisë? Zero! Kemi pasur vetëm një, që është thënë e zeza mbi të bardhë në rekomandimin 98 të Komisionit të Venecias. Kur ky proces, Vetting-u bëhet nga forca politike, e cila ka maxhorancën, atëherë ka rrezik të kapjes së sistemit gjyqësor. E kemi thënë, kemi ngritur hipotezën. Komisioni i Venecias, Rekomandimi 98, fjalia e fundit thotë pikërisht këtë gjë. Ky ka qenë shqetësimi ynë: ata që do të bëjnë Vetting-un të mos jenë njerëzit e Partisë Socialiste, por të jenë të një institucioni tjetër. Pra, për këta dy komponentë ne të gjitha palët kemi qenë dakord.

Ka pasur vetëm një gjë në komponentin e tretë, pra për skemën sesi do të bëhet i gjithë organizimi i pushtetit gjyqësor dhe cilët janë këta njerëz që do t'i popullojnë këto institucione dhe kush do t'i emërojë. Ky ka qenë debati. Krijohet një skemë me 8 institucione të reja dhe Komisioni i Venecias thotë se është e komplikuar dhe këta nuk duhet t'i zgjedhë maxhoranca. Kur ajo ka 3/5, duhet të jetë maxhorancë më e lartë se 3/5, jo për të përfituar opozita, sepse opozita nuk përfiton gjë, por për të mos lënë pikërisht maxhorancën, e cila në çdo vend është në konflikt interesi, duhet që të jetë një numër më i madh se maxhoranca. Ky ishte i vetmi shqetësim ku ne ndahemi në draftin për reformën për drejtësi. Në përmbajtjen e këtij drafti shqetësimi ynë i vetëm është vetëm ky dhe jo mekanizmat e tjerë.

Komisioni i Venecias foli qartë kur tha se duhet një konsensus për një reformë të qëndrueshme. Konsensusin, bazuar te Komisioni i Venecias, krerët politikë e përshëndetën. Konsensusi, bazuar te “Venecia”, ngelet kërkesë e Komisionit të Venecias dhe ai buron nga vullneti i mirë. Vullneti ynë i mirë u tregua kur ekspertët kërkuan që drafti i reformës të

pasqyronte të gjitha pikat, 138 pikat e Komisionit të Venecias. Ku qëndron këtu konflikti? Konflikti qëndron kush do t'i implementojë 138 pikat? Kush do t'i implementojë 120 pikat dhe të lërë jashtë 18? Cila ishte përgjigja ndaj këtij vullneti të mirë që shprehu Partia Demokratike? Ishte hartimi i një drafti në mënyrë të njëanshme. Ishte një urdhër politik ndaj ekspertëve: bëni një draft dhe na i sillni! Kjo e minon dhe e kontaminon konsensusin, kërkon që të futet dhe ta drejtojë në një rrugë tërësisht jopozitive, të një vullneti të keq, reformën në drejtësi.

Pati një marrëveshje më 8 janar, që ju të tërhiqeshit nga vullneti i keq, ishte konstatim, dhe u dakordësua nga partnerët ndërkombëtarë. Kjo është një gjë shumë e mirë, e cila u përshëndet. Të gjithë e përshëndetën, edhe qytetarët e përshëndetën, edhe media e përshëndeti. “Sa mirë!”- thanë! U tërhoqën nga drafti që ishte përgatitur dhe do të ulen bashkë të bëjnë një draft bazuar te “Venecia”. Por, a ka ndonjë qytetar që të thotë: “Duam një draft që nuk bazohet te Venecia. Asnjëri! Ka vetëm një interes, që t'i shmangemi pak Komisionit të Venecias”? Ekspertët u ulën dhe, me vullnet pozitiv filluan të gjenin shqetësimet. Kryeshqetësimi i “Venecias”, sipas nesh, është rekomandimi 55, kapja politike, çimentimi politik në rast se emërimi i gjithë këtyre funksionarëve dhe gjithë kjo skemë do të bëhet nga maxhoranca, qoftë kur është kjo maxhorancë, qoftë nga ajo tjetra, sepse Kushtetuta nuk bëhet vetëm për një javë, për një mandat apo vetëm për një periudhë të caktuar. A ka vullnet për ta implementuar këtë rekomandim? Kjo është çështja. A ka vullnet nga forcat politike që ta implementojnë këtë rekomandim, që skema, sipas rekomandimit 65, të thjeshtohet, që popullimi i skemës së re të mos bëhet me 3/5, por të bëhet me një shumicë tjetër, në mënyrë që njerëzit, të cilët do të emërohen për të kontrolluar, për të emëruar, për të shkarkuar, për të transferuar gjyqtarët të mos i emërojë as Rama, as Basha, as Meta dhe askush tjetër? Pra, kupola e drejtësisë të mos emërohet nga shefat e maxhorancës aktuale sot, por edhe nga shefat e maxhorancës që do të vijnë, se vitet ikin shpejt. Kjo është çështja thelbësore e draftit. Ai që fiton zgjedhjet, nuk duhet t'i marrë të gjitha pushtetet. Ky është parimi që funksionon në një demokraci funksionale, ndaj edhe çështja e drejtësisë duhet t'i kalojë votat e pushtetit. Kur ke 71 vota, duhet që ata që do t'i emërojnë të kenë 84 vota. Kur ke 84 vota, duhet të jenë 94 vota. Kjo është ajo që themi ne. Kjo është ajo që ka thënë “Venecia” në rekomandimin 55 për Shqipërinë dhe jo vetëm për Shqipërinë, por duke iu referuar edhe opinionit për Hungarinë. Kaq racionale ishte kjo, sa edhe ekspertët e huaj kanë propozuar këtu, e kam të shkruar, dhe u gjet zgjidhja. Për aq kohë sa keni 84 vota, deri në zgjedhjet e ardhshme të jetë 94 vota. Ekspertët tuaj gjatë asaj nate, siç më raportojnë mua, se unë

nuk isha atje, kanë rënë dakord, por kanë thënë do të pyesim. Këtu u dekonspirua i gjithë qëllimi i mirë. Të nesërmen pyetën dhe thanë: “Jo, jo nuk jemi dakord me këtë formulë”. Kjo nxjerr në pah qëllimin e keq për t’iu shmangur Komisionit të Venecias.

Ne nuk kemi debat këtu nëse do të largohen apo jo gjyqtarët e korruptuar? Jo nuk kemi! Nuk e kemi pasur ndonjëherë, as edhe një ditë, nuk e kemi pasur këtë debat. Por ne nuk mund të pranojmë sesi alibia e luftës ndaj korrupsionit është të kapet kokë e këmbë sistemi i drejtësisë. I mora votat, i dua të gjitha pushtetet.

Ndaj çështja e përmbajtjes që ka ngelur për t’u diskutuar është pikërisht këtu. Kemi vullnet të mirë për konsensus, që në Kushtetutë të vendoset që njerëzit e drejtësisë, që do të bëjnë largimin e gjyqtarëve, prokurorëve të korruptuar, emërimin, promovimin e kështu me radhë, të mos i emërojë maxhoranca sot dhe as nesër, të mos ketë asnjë implikim politika në këtë proces as maxhoranca, as opozita. Kjo është çështja që tregon vullnet të mirë ose vullnet të keq për të përkrahur draftin e reformës në drejtësi. A keni vullnet të mirë që ne të zbatojmë rekomandimin 55 të Venecias? Se me 84 vota Venecia thotë: “E çimenton kapjen”. Apo ju intereson vetëm kapja?

Nëse nuk keni ndër mend të kapni drejtësinë, siç thotë “Venecia”, nëse kemi vullnet vetëm ndaj luftës së korrupsionit, këtë vullnet demonstroheni, siç e demonstrojmë ne. Lëruani draftin ekspertëve, lëreni në dorë të lirë, ashtu siç bëmë edhe në takimet me ekspertët ndërkombëtarë, me implementimin konkret, standard të Komisionit të Venecias dhe të dalim me një draft të vetëm, i cili implementon 138 rekomandimet e Venecias. Nëse kemi vullnet të mirë dhe jo si qëllim kapjen, atëherë heqim dorë nga skema institucionale që keni krijuar dhe zbatojmë atë që kërkon “Venecia” në rekomandimin 66 dhe rekomandimin 69, një skemë që shmang kapjen. Ndërtojmë një skemë të re. E ndërtojmë me ekspertët ose e ndërtojmë këtu së bashku për 3 ditë. Ne juristë jemi. Këto janë çështje që na ndajnë dhe tregojnë nëse kemi apo jo vullnet të mirë për procesin.

Sot është koha për të treguar dhe të heqim maskat para publikut dhe për të treguar vullnetin e mirë. Ajo që propozoj është për çështje që ekspertët kanë evidentuar që ndahen, pra ato që janë ndarë, të ulemi bashkë dhe me vullnet të mirë t’i zgjidhim në përputhje me standardet e Komisionit të Venecias.

Çështjet që ndajnë ekspertët, nuk kanë të bëjnë as me mekanizmin e luftës kundër korrupsionit gjyqësor, as me luftën ndaj korrupsionit zyrtar të lartë, as me luftën në sistemin e

drejtësisë, në kontrollin e pasurive. Zgjidhjet që ka dhënë Komisioni i Venecias janë integruar, një pjesë e tyre janë në lidhje edhe me Vetting-un, por kanë të bëjnë vetëm me kapjen. Kjo është kërkesa jonë procedurale në mënyrë që të mbrohet konsensusi sipas Komisionit të Venecias.

Së fundi, lidhur me pjesën e përmbajtjes së draftit të hartuar në mënyrë të njëanshme, duhet të them se reforma kushtetuese është pa dyshim një pjesë mjaft e rëndësishme e reformës në drejtësi. Unë e dëgjova prezantimin. E kam lexuar edhe materialin e përgatitur nga ekspertët e emëruar prej jush. Ky draft, në fakt, ka shumë ndryshime, për të mos thënë aspak nga drafti parafabrikat i 29 dhjetorit apo ndryshime shumë të vogla. Drafti pasqyron një pjesë të rekomandimeve të Komisionit të Venecias, që kanë të bëjnë me largimin e vetëm prezencës së Ministrisë të Drejtësisë. Kanë të bëjnë edhe me çështjet e Vetting-ut, me çështjen e të drejtave të gjyqtarëve, të prokurorëve e me radhë. Kapitujt e luftës ndaj korrupsionit në drejtësi dhe ato kundër korrupsionit të zyrtarëve të lartë janë përmirësuar pas ardhjes së Komisionit të Venecias. Por ka të paktën 11 rekomandime, të cilat nuk janë implemetuar, nuk është implementuar rekomandimi 55. Pse nuk është implementuar rekomandimi 55? Pikërisht, rekomandimi 55 flet shqetësimin që ka ngritur opozita. Njerëzit që do të emërohen në të gjithë kupolën e drejtësisë, nuk do të emërohen nga ekzekutivi, sepse ekzekutivi është në konflikt të hapur interesi. Ekzekutivi gjithmonë kërkon të mbrojtë pikërisht ato monopole, ato shkelje të ligjit që bëhen në çdo vend dhe këtu aq më shumë, të mbulojë korrupsionin dhe të mbrojtë ata njerëz për të cilët ka ardhur në pushtet, sepse është ndërkombëtarisht e njohur që qeveria “Rama” i fitoi zgjedhjet në bashkëpunim me krimin. Është e njohur kjo. Nuk ka sallë, nuk ka parlament të Europës që nuk e di. Sigurisht, qeveria është në konflikt interesi në këtë pjesë. Në qoftë se e bën për të kapur, e bën, sepse do ta bëjë për të mbrojtur ata njerëz për të cilët ajo erdhi në pushtet. Nuk u implementua rekomandimi 65, përmirësimi i skemës. Skema krijon kapjen. Rekomandimi 10, rekomandimi 69 që ka të bëjë me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, institucioni më i rëndësishëm që bën edhe pjesën e mekanizmit zhblllokues në rastet kur dy forcat politike nuk merren vesh me njëra-tjetrën, “Venecia” thotë: “Ky këshill nuk duhet të jetë”. Pse ngulët këmbë që të jetë ky këshill? Ngulet këmbë, sepse është ndërtuar në atë mënyrë që të çimentojë kapjen e sistemit në drejtësi.

Çfarë thotë rekomandimi 98 i Komisionit të Venecias? Thotë që komisioni që do të bëjë të gjithë Vetting-un, nuk duhet të jetë nga maxhoranca, sepse thotë: “Procesi i Vetting-ut, i gjyqtarëve dhe i prokurorëve është një çështje që ka nevojë politike dhe Komisioni i Venecias

nuk është në një pozicion që të deklarohet lidhur me të, megjithatë duhet pasur parasysh se një zgjidhje e tillë radikale do të ishte e pavend në kushte normale, sepse krijon tensione të jashtëzakonshme, brenda gjyqësorit. Por, meqenëse ju keni rënë të gjithë dakord, e konfirmon Venecia, kjo duhet të jetë si çdo masë e jashtëzakonshme krijon rrezikun e kapjes së gjyqësorit nga forcat politike që kontrollojnë procesin”. Çfarë thotë me këtë? “Venecia” thotë: “Që personat që do të kontrollojnë procesin, nuk duhet të jenë nga forcat politike që drejtojnë procesin, pra duhet të jenë nga një forcë tjetër.

Çfarë thotë rekomandimi 127? “Metoda e përzgjedhjes së kandidatëve me 3/5, me propozim të Avokatit të Popullit, dhe pas një thirrje publike për kandidat, duket i arsyeshëm në teori, duke qenë se shumica e tanishme”, duket se kontrollojnë 3/5 e Kuvendit, nuk e konstatojmë ne, është fakt, këtë e thotë edhe Komisioni i Venecias. Do të ishte e përshtatshme që pushteti i emërimit të këtyre personave t’i jepej një organi të pavarur, ose një zyrtari që nuk është i të njëjtës ngjyrë politike si shumica e tanishme, këtë thotë fjalia e fundit e rekomandimit 127. Pra , ata që do të bëjnë procesin e Vetting-ut, të mos i emërojë e njëjta forcë politike, e cila ka maxhorancën. T’i emërojë, thotë, një organ i pavarur ose një zyrtar që është i së njëjtës vijë politike. Nuk është implementuar Rekomandimi 132 dhe një pjesë e mirë e rekomandimeve 137.

Në përfundim do të thosha që qëndrimi ynë si opozitë, si Parti Demokratike është i qartë, se në Venecia duhet të shkojmë me një draft të vetëm, me një draft, i cili mbështetet në konsensus, sipas Venecias, i cili implementon një më një 138 rekomandimet e Venecias. Vetëm konsensusi, sipas Komisionit të Venecias, është çelësi për të pasur një reformë në drejtësi që të përmbush kriteret dhe standardet që kërkohen nga partnerët dhe nga qytetarët shqiptarë. Luftë ndaj korrupsionit në drejtësi, luftë ndaj pandërshtueshmërisë, një drejtësi të pavarur dhe të pakapur.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kush e do fjalën?

Po, zoti Braho, zoti Mediu dhe më pas zoti Majko.

Spartak Braho – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua të nënvizoj, si përfaqësues në këtë komision të nderuar, se me të drejtë thuhet që ky komision ka marrë përsipër që të çojë përpara një reformë historike për shtetin. Duke pasur parasysh këtë fakt, që është pozitiv, është mjaft pozitive që ne u rimblodhëm për të filluar edhe

një herë këtë proces dialogu të ndryshimeve kushtetuese dhe që lidhet me misionin e përfundimit të reformës në drejtësi.

Gjithashtu, dua të nënvizoj një fakt tjetër, duke theksuar se ne e vlerësojmë pozitivisht punën e ekspertëve të të gjitha kategorive, duke pasur parasysh edhe kontributin e veçantë të ekspertëve ndërkombëtarë. Ne nuk kemi arsye pse ta mohojmë pozitivitetin, angazhimin e kësaj pune. Natyrisht, ne jemi në proces, duhet të vazhdojmë të jemi në proces të dialogut dhe shqyrtimit, të materialit apo të brumit që ekspertët deri tani, më pas edhe me brumë tjetër, duke pasur parasysh edhe vërejtjet që do të vijnë nga ekspertë të opozitës, apo vërejtje që vetë ekspertët ligjor të Lëvizjes Socialiste për Integrim kanë, të vazhdojmë të jemi aktiv, por nuk duhet të mohojmë pozitivitetin e kësaj pune deri tani.

Në këtë sens, Lëvizja Socialiste për Integrim fton edhe një herë të gjithë përfaqësuesit në këtë komision të nderuar, natyrisht edhe të gjitha forcat politike, jo vetëm përfaqësuesit, të vazhdojnë dialogun, dialogu është mjeti, konsensusi është rruga ku duhet të qëndrojmë. Nuk mund të shkojmë te konsensusi profesional, jo konsensusi i pazareve, por konsensusi profesional, duke vazhduar pa ndërprerje dialogun. Ky i fundit bëhet këtu, dialogu politik, dialogu profesional bëhet këtu në tavolinë dhe jo duke u larguar nga ajo.

Unë e ritheksoj edhe një herë këtë kërkesë. Nuk kam arsye pse të mos e përshëndes dhe ardhjen e përfaqësuesve të opozitës. Kam përshtypjen se edhe ata do të vazhdojnë të jenë aktivë në procesin e dialogut.

Duke u futur në terrenin konkret, duke nënvizuar edhe një herë se ne tashme kemi një brum në dorë, ku secili nga ne është edhe në pozitat politike, edhe në pozitat e merakut, se ka kapje. Pra ka një paragjykim reciprok të palëve, e cila është kthyer në paranojë me të drejtë. Janë historitë reciproke të cilat i nxisin këto paranoja, por ne në komision na dominon fakti se jemi profesionistë, nga të gjitha palët edhe këtej edhe andej jemi juristë. Duhet të paragjykojmë sa më pak njeri-tjetrin për të dëgjuar me respekt edhe ato që propozon pala tjetër, por edhe pala tjetër të dëgjojë me respekt ato që propozon maxhoranca. Pra, duke kaluar në terrenin konkret unë, siç e theksova, mbështes punën e deritanishme, draftin e paraqitur. Duke qenë i hapur, vë në dukje se edhe ndaj këtij drafti voluminoz, një pune voluminoze, ne kemi rezervat tona. Për shembull, ne ndahemi me draftin te sistemi i karrierës. Ne duam të dominojë sistemi i karrierës dhe ai të jetë thelbi i kritereve.

Së dyti, kemi një mendim ndryshe për sa i përket mandatit të institucionit.

Së treti, kemi një riformulim tjetër lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas modelit gjerman.

Kemi një opsion tjetër lidhur me organizimin e Gjykatës së Lartë, duke gjykuar se Gjykata e Lartë duhet të jetë një dhe e vetme, e ndarë sipas seksionit.

Kemi një gjykim tjetër lidhur me organizimin e prokurorisë, duke e parë atë si një organ të unifikuar, me të drejtën apo me mundësinë që të funksionojnë pranë saj edhe strukturat e tjera të posaçme antikorrupsion. Për sa kohë që themi se është Prokurori i Përgjithshëm që raporton në Kuvend, nuk mund të ketë struktura të tjera, të cilat raportojnë në Kuvend përveç Prokurorit të Përgjithshëm. Kështu e ka përcaktuar Kushtetuta.

Së fundi, jemi për një rol më aktiv apo për formulime, të cilat e rrisin rolin aktiv të Ministrit të Drejtësisë e të tjera, por nuk dua të zgjatem. Vërejtjet janë këtu dhe do t'ia dorëzoj zotit Xhafaj për t'i paraqitur edhe këto mendime, vërejtje, apo riformulime që ia kemi paraqitur Komisionit të Venecias.

Thelbin e këtyre propozimeve na i orientojnë vetë vërejtjet apo sugjerimet e Komisionit të Venecias që, përveç dhjetëra vërejtjeve të karakterit teknik, kanë edhe një problematikë shumë parimore.

Çfarë kërkon Komisioni i Venecias? Procesi të jetë konsensual. Ne kësaj gjëje nuk i shpëtojmë dot. Kush i largohet konsensusit, procesit konsensual apo dialogut, nuk përfill orientimet e Komisionit të Venecias.

Ndërhyrjet në Kushtetutë, pak a shumë duhet të jenë minimaliste.

Sokol, gjykoj se janë bërë rreth 60 ndryshime në Kushtetutë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, ndryshime kushtetuese.

Vërejtja jonë është që shumë gjëra mund të aplikohen apo të zhvillohen nëpërmjet ligjeve funksionale për organizimin e këtyre institucioneve.

Një vërejtje parimore, e cila na detyron për të paraqitur edhe vërejtjet që thashë më sipër, është reduktimi i institucioneve që krijohen për të mos pasur shumë institucione, të cilat, në vend që të ndihmojnë procesin e pastrimit dhe funksionimit normal të drejtësisë, do ta pengojnë atë.

Këto janë pak a shumë mendimet.

Unë gjykoj që ne si komision duhet të vazhdojmë punën pa ndërprerje sipas një itinerari, në mënyrë figurative do të thosha me disa stacione: stacioni i parë është puna e ekspertëve, stacioni i dytë është komisioni, stacioni i tretë është Venecia, vajtje-ardhje disa herë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj- Faleminderit, zoti Braho!

Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu - Faleminderit, zoti Xhafaj!

Pa dyshim të gjithë pajtohemi me faktin se kjo është një reformë jashtëzakonisht e rëndësishme, e cila vjen si produkt i një procesi politik, sepse vetë Kushtetuta ia ka dhënë legjislativit autoritetin e këtij procesi apo edhe ndryshimet kushtetuese me dy të tretat e tij. Duke qenë kështu është jashtëzakonisht e rëndësishme jo vetëm nga pikëpamja formale, por sidomos nga ajo thelbësore që Kuvendi i Shqipërisë të ushtrojë të gjithë autoritetin që i takon në vlerësimin, njohjen e kësaj problematike, e cila vjen si draft i propozuar nga ekspertët, por në fund fare, me gjykimin e një arbitri, siç është Komisioni i Venecias, për të shmangur edhe ato që tha zoti Braho, paragjykimet që kemi për njëri-tjetrin apo paranojat, prandaj e dërguam në Komisionin e Venecias.

Ne jetojmë në një realitet që e njohim të gjithë dhe ekspertët që janë prezentë reflektojnë në njëfarë mënyre apo tjetër sensitivitetet e palëve politike. Për të shmangur të gjithë këto njëanshmëri apo gjykime, të cilat mund të krijojnë ngërçe në proces, ne adresuam në Komisionin e Venecias gjykime të ndryshme edhe për draftin e parë. Komisioni i Venecias përcolli rekomandimet e veta. Unë pajtohem me zotin Halimi jo nga pikëpamja formale procedurale, por nga pikëpamja thelbësore, se do të ishte shumë e rëndësishme që këto rekomandime të Komisionit të Venecias të ishin pjesë e debatit të këtij komisioni në radhë të parë, për të parë se cilat ishin rrugët ose gjykimet tona të përbashkëta dhe për t'i adresuar pastaj tek ekspertët e të dyja palëve, të të gjitha niveleve në mënyrë që të arrijmë në një produkt sa më konsensual.

Mendoj se do të ishte e rëndësishme ta bënim këtë proces dhe për t'i lexuar drejt rekomandimet e Komisionit të Venecias, nëse do t'i mblihdja në tre grupime.

E para, është nevoja për një konsensus politik. Mendoj se kjo ka një rrjedhë logjike. Çfarë ndodh? Ne jemi ulur këtu për të realizuar një konsensus politik, sepse nuk mund të votohet ndryshe as drafti, pa pasur dy të tretat. Kërkojmë të kemi një mirëkuptim politik për të

përcjellë një reformë si në ndryshimet kushtetuese, ashtu edhe reformën në gjyqësor me dy të tretat. Ajo që unë shikoj si problematike në atë që përcjellin ekspertët në këtë draft është se nëse na kërkoni neve të japim konsensusin politik për dy të tretat për të votuar draftin, shkoni në një pikë ku thoni se nuk kemi nevojë më për dy të tretat, por për tre të pestat, që i ka kjo maxhorancë. E dimë se si i ka bërë tre të pestat për të votuar për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të pushtetit gjyqësor: organizimin, funksionim, emërimin. Të tria këto elemente shumë të rëndësishme për pavarësinë e gjyqësorit mbeten në dorë të një maxhorance, nuk ka rëndësi, është e së majtës apo e së djathtës, është Rama, Basha, apo kushdo që të jetë. Komisioni i Venecias ngre shqetësimin se nuk duhet të jenë produkt i një maxhorance.

Ekspertët e dinë shumë më mirë që ligjet votohen me tre të pestat me shumicë të cilësuar apo me dy të tretat, nuk kanë të bëjnë thjesht me numrat se si është organizuar dhe funksionon një parlament në një kohë të caktuar, por kanë të bëjnë në thelb nga pikëpamja kushtetuese me qëndrueshmërinë dhe tejkalimin e interesit politik të një maxhorance të caktuar për ligje që votohen me tre të pestat apo me dy të tretat, sepse efektojnë pjesën më të madhe të shoqërisë. Prandaj është shumë i rëndësishëm që ky proces të shikohet si një proces i një marrëdhënie të qenësishme politike të dy krahëve, si në rastin kur votohet me tre të pestat, por sidomos në rastin kur votohet me dy të tretat.

Unë mendoj se është jo i drejtë shqetësimi që ngrihet që ju kërkoni dy të tretat, sepse doni të bllokoni procesin. Nëse ne donim të bllokonim procesin, nuk kishin pse të ishim prezentë këtu në proces dhe kemi qenë shumë seriozë. Siç e tha edhe zoti Halimi biem dakord, për pjesën më të madhe të problematikës së parashtruar në draft, por ngremë njëkohësisht shqetësimin që është dhe shqetësimi i Komisionit të Venecias që me tre të pestat, jo vetëm nuk garantohet pavarësia, por çimentohet një lloj kontrolli politik i pushtetit gjyqësor, që do të ishte në dëm të interesave të shoqërisë shqiptare, të një shteti të së drejtës, i cili jo vetëm nuk do të luftonte korrupsionin, por do t'i shtonte këtij korrupsioni edhe kontrollin politik. Prandaj ne kemi shtruar nevojën e domosdoshme, siç e ka rekomanduar edhe Venecia për një bashkëpunim ndërmjet krahëve politikë, gjykuar në mendimin e ekspertëve për të gjetur zgjidhjet që procesi që ka të bëjë me organizimin strukturor, me funksionimin dhe me emërimin e pushtetit gjyqësor, të ketë një mbështetje sa më të gjerë politike dhe të mos jetë i kontrolluar në asnjë moment të vetëm nga asnjë krah i politikës.

Pavarësisht se çfarë ka ndodhur në këtë histori ne jemi këtu për të hapur një faqe të re historie në mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të pushtetit gjyqësor.

Ajo që do të thosha tjetër është shqetësimi i dytë i Venecias që mendoj se është shumë legjitim për thjeshtimin e strukturës, e cila nuk ka të bëjë se sa kuadrate ne vendosim në skemën e organizimit të gjyqësorit, por ka të bëjë në thelb me funksionimin e tyre, sidomos me shqetësimin që ata ngrenë që përveç kontrollit politik që duhet ta shmangim, është edhe shmangia e kontrollit të gjyqësorit nga një grup njerëzish që, në rastin më të keq siç është këtu, mund të zgjidhen në mënyrë politike duke ngushtuar hapësirat e domosdoshme për të bërë një karrierë të mirëfilltë në sistemin gjyqësor të njerëzve të cilët kanë aftësitë për ta bërë këtë karrierë në nivelin më të ulët deri në atë më të lartë të gjyqësorit.

Duke u nisur nga të gjitha këto, është shumë e rëndësishme, të nderuar kolegë, të hyjmë në një vlerësim të plotë të rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe ta dëgjojmë me vëmendje njëri-tjetrin. Pa dyshim është një proces i rëndësishëm për sa i përket fillimit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, por më i rëndësishëm se sa thjesht momenti i këtyre negociatave, është në thelb çfarë ajo do t'i sjellë qytetarit shqiptar, organizimit dhe funksionimit të shtetit shqiptar, pranimit *check and balance* dhe një pushteti gjyqësor të pavarur.

Mendoj se më tepër sesa nxitmi vlen që ne të ulemi me njëri-tjetrin dhe të pranojmë, të gjykojmë mbi mendimin e ekspertëve dhe sidomos mbi rekomandimet e Komisionit të Venecias. Baza, në gjykimin tonë, për arrijten e një konsensusi të plotë, por edhe për të funksionuar në përputhje me Kushtetutën mbi parimin *check and balance* dhe njëkohësisht të garantimit të pavarësisë së gjyqësorit janë rekomandimet e Venecias.

Shqetësimi ynë është që në draftin e paraqitur ka elemente, të cilat nuk respektojnë rekomandimet e Venecias dhe nuk garantojnë pavarësinë e gjyqësorit. Mund të kemi debate rreth kësaj çështjeje, mund të kemi gjykime të ndryshme, por do të ishte shumë më e mirë që ne t'i merrnim një për një të gjitha rekomandimet e Komisionit të Venecias, t'i arsyetojmë dhe të arrijmë në gjykime të përbashkëta për të garantuar këtë konsensus.

E përsëris edhe një herë, nuk ka vlerë të kërkohet angazhimi i opozitës për të realizuar dy të tretat për një konsensus në parlament për miratimin e draftit, pastaj të thonë që politikisht opozita nuk vlen më, pavarësisht se cila është opozita, sepse të gjitha do t'i miratojmë me tre të pestat sipas interesit politik të një krahu të caktuar për të çuar në struktura përkatëse, në

drejtim të gjyqësorit apo edhe në të gjithë procesin e emërimit të gjyqësorit njerëzit që ne kemi interesin tonë politik. Kjo do të bënte që kjo reformë të ishte tërësisht regresive dhe problematike për të ardhmen e shoqërisë shqiptare.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Mediu!

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Faleminderit!

Unë do ta nis diskutimin tim, së pari duke vlerësuar jo në mënyrë cinike të gjithë atë punë që është bërë muaj pas muaji nga ekspertiza qoftë ajo shqiptare qoftë ajo ndërkombëtare. Kur them nga ekspertiza shqiptare, dua të nënvizoj faktin e përfshirjes së ekspertëve të opozitës, prandaj dhe përdora fjalën e vlerësimit jo cinik, pasi tani çështja e ndryshimit në Kushtetutë është bërë një temë qendrore në diskutimet jo vetëm të medias, jo vetëm të politikës, por edhe të publikut.

Kolegët e opozitës mendoj se kanë të drejtën e natyrshme, si opozitë të shprehin mosbesim. Ajo që dëshiroj të nënvizoj edhe në emër të të gjithë kolegëve përfaqësues të Partisë Socialiste, këtu është se ne kemi ardhur me një qëndrim shumë të qartë për të ndryshuar Kushtetutën që nuk është pronë e asnjë partie, por është pronë e të gjithë shtetasve dhe sigurisht konsensusi politik do të jetë kryefjala e diskutimeve tona të përbashkëta.

Ajo që dëshiroj të them në emër të PS-së është se ne do t'i qëndrojmë në mënyrë konsekuente asaj që kemi thënë në fillim të procesit, që këtë proces ne do ta bëjmë së bashku, ekspertët ndërkombëtarë dhe ata vendas, pasi në çdo rast ky do të jetë një proces shumë delikat, i cili do të prekë fatet e një marrëdhënieje shumë të rëndësishme, shumë të veçantë që është marrëdhënia e politikës me drejtësinë.

Ritheksoj faktin që konsensusi politik, ashtu siç thanë edhe kolegët e partive të tjera, është shumë i rëndësishëm në këtë diskutim, por besoj dhe jam i bindur se do të kemi mirëkuptimin e kolegëve të mi, se prevalenca përballë konsensusit politik është edhe një pyetje tjetër që ka të bëjë jo vetëm me konsensusin politik, por me integrimin e Shqipërisë në BE.

Mendoj se integrimi në BE lidhet shumë me këtë reformë, prandaj duke kërkuar edhe këtë mirëkuptim, jemi duke ecur natyrshëm të qetë dhe në vazhdim të opinionit që shprehu kolegu i PD-së lidhur me ndoshta mostrajtimin në mënyrë shumë të qartë të vërejtjeve të Komisionit të Venecias nga ana e ekspertëve. Çfarë po bëjmë ne sot? Po i drejtohem Komisionit të Venecias për t'u shprehur ai, sesi janë reflektuar vërejtjet që ka bërë ky komision.

Mendoj se ne nuk kemi të drejtën dhe nuk mund të bëhemi përfaqësues, askush nga ne këtu, i Komisionit të Venecias dhe të themi se si i kanë trajtuar ekspertët vërejtjet e Komisionit të Venecias. Ekspertët, me shumë të drejtë, na propozojnë që t'i drejtohem përsëri Komisionit të Venecias lidhur me ndryshimet dhe sesi janë reflektuar propozimet e tyre.

Në këtë pikë, edhe unë së bashku me kolegët do t'i drejtohem karshi edhe asaj që foli kolegu Braho nga ana e LSI-së, dhe, për shembull, me një reflektim që do të na duhej nga ana e Komisionit të Venecias lidhur me çështjen e përdorimit të shumicës së dy të tretave apo të tre të pestave.

Ne, në fund fare, duam të kemi një sistem funksional dhe jo një sistem, i cili të diskutohet në marrjen ose jo nga politika në duart e saj të qeverisjes së drejtësisë. Nëse diskutojmë për pavarësinë e drejtësisë, mirë është të kthejmë një herë sytë dhe të shikojmë sesi është sot sistemi i drejtësisë. Me të drejtë dhe mendoj se këtu nuk jam duke bërë retorikë, ne i detyrohem një ndjesë publike shumë të qartë të gjithë atyre gjyqtarëve, prokurorëve të cilët me ndershmëri sot kryejnë detyrën sipas ligjit dhe Kushtetutës, por jam i bindur dhe besoj qartë se sot ne kemi një problem shumë të madh që na detyron të diskutojmë edhe mandatet e këtyre njerëzve, të cilët jam i bindur se nesër pas kësaj reforme do të jenë në të njëjtat pozicione për të mos thënë edhe më shumë.

Nga ana tjetër, parlamenti nuk po tregohet i njëanshëm, por e ka filluar këtë metodologji nga vetja. Ligji i dekriminalizimit, në thelb ka të bëjë me ndërprerje mandatesh. Besoj se çdo jurist arrin ta kuptojë këtë. Parlamenti e ka filluar nga vetja, për ta vazhduar me sistemin e drejtësisë.

Unë mendoj se ky konsultim i gjerë që ne po bëjmë nën drejtimin e ekspertizës ndërkombëtare, dhe në këtë drejtim dua që, në mënyrë të veçantë, në emër të Partisë Socialiste të falënderoj Shtetet e Bashkuara të Amerikës, misionin e Bashkimit Europian dhe ekspertizën përkatëse, për ndihmën që po na japin. Ne do të jemi konsekuentë, për t'iu përmbajtur parimeve qendrore të reformës, e cila do t'i hapë dyert integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Kjo nuk është as retorikë e as metaforë. Ky është një realitet, është një luftë për të mos lejuar që ne të quhemi nesër përfaqësues të një shteti të dështuar.

Jam i bindur, kolegë, se me një diskutim të hapur, transparent, me ndihmën e Komisionit Europian, ekspertizës ndërkombëtare, ne i kemi të gjitha mundësitë për të rënë dakord. Por, edhe nëse do të biem dakord që të mos biem dakord, mendoj se në funksion të

transparencës kemi edhe një rrugë të fundit, të ndershme, që është shkuarja te publiku: referendumi.

Mendoj se kjo është e natyrshme, për t'i dhënë fund çdo lloj skenari se diku po gatuhet një grusht shteti për marrjen në duar të sistemit të drejtësisë nga ana e një partie politike. Besoj se çdo jurist, por dhe çdo njeri që nuk kupton nga shumë prej diskutimeve që dëgjon rëndom nëpër televizione apo në medien e shkruar, arrin të kuptojë se një parti me 62 vota nuk mund të bëjë grusht shteti në Shqipëri.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ju faleminderit, zoti Majko!

Zoti Bylykbashi. Pastaj zonja Hysi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar!

Sot është mbledhje shumë e rëndësishme, për shkak të asaj që tha zoti Halimi.

Kjo mbledhje duhej të ishte bërë menjëherë pas miratimit të raportit të Komisionit të Venecias dhe prezantimit të këtij raporti pranë parlamentit të Shqipërisë, që do të thotë pranë këtij komisioni dhe jo pranë grupit të ekspertëve. Grupi i ekspertëve është një entitet, i cili funksionon pranë komisionit, për komisionin. Legjitimitetin e punës që bën e merr prej nesh, prej këtij parlamenti, dhe nuk ka iniciativë të vetën.

Diku kam dëgjuar një shprehje, në të cilën thuhet se kjo nuk është Republika e ekspertëve, dhe kjo është shumë e vërtetë.

Të gjithë 140 gratë dhe burrat e këtij parlamenti do të duhet të votojnë, të ngrenë duart, dhe unë shpresoj që të kemi 140 vota atë ditë – dhe shpresoj të mos jetë e largët ajo ditë – kur të miratojmë ndryshimet kushtetuese për reformën në drejtësi, kur t'i shtrëngojmë dorën njëritjetrit, duke qenë të bindur se kemi bërë një gjë të madhe. Kjo nënkupton dhe konsensusin, por mbi të gjitha, nënvizoj atë që thashë: ne do të votojmë, dhe ne nuk votojmë sepse të tjerë vijnë e ngrenë duart. Ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për detyrën e madhe, për rolin e madh, për një përgjegjësi shumë të madhe që na ka dhënë neve sot momenti, ndoshta. Qoftë dhe pamundësia ndër vite për ta bërë këtë reformë – ju e kujtoni se si kohë më përpara ishte e pamundur të miratohej edhe ndryshimi në kodin hekurudhor – e për rrjedhojë, nëse ne do ta kemi këtë fat, që me konsensus të gjejmë zgjidhjet më të mira kushtetuese e teknike për reformën në drejtësi, ky do të ishte një fat i madh për të gjithë shqiptarët, jo vetëm për ne që jemi këtu.

Ajo që ka ndodhur deri më sot është totalisht e kundërta e kësaj. Kjo sallë këtu ka parë ndër vite procese aspak më të parëndësishme se ky për të cilin po flasim sot ne. Reforma themelore, përfshirë edhe atë kushtetuese, të cilat janë bërë – për fatin e mirë- me një metodologji krejt tjetër nga kjo me të cilën, për fat të keq po funksionon ky komision. Aspak nuk dua ta vë theksin te fakti se pse Parlamenti i Shqipërisë konsideroi se ishte më mirë për një reformë shumë të rëndësishme, siç është ajo zgjedhore, që ne nuk e dimë se deri ku mund të shkojë, që duhej një format tjetër, format i cili garanton konsensus, garanton edhe kualitet.

Me sa duket Parlamenti është përnduar për atë që ka bërë deri më sot. Në fakt e tregon edhe produkti. Në bindjen time të thellë, është për të ardhur keq që ne kemi humbur të paktën gjashtë muaj kohë. E mas nga momenti kur opozita vendosi, në mënyrë fare të qartë, t'i kthehej procesit, duke u bashkuar, me të gjitha resurset e veta, ne që jemi këtu dhe ekspertët tanë.

Sigurisht është punuar akoma më gjatë, por po flasim sikur neve të kishim vetëm gjashtë muaj kohë – gjashtë muajt e fundit – dhe të punonim fort përditë, natën ta bënim ditë, dhe të prodhohim 67 amendamente kushtetuese, unë besoj se jo 67, por mund të kishim bërë një mrekulli.

Pra, ajo që është për të ardhur keq, është një kohë kaq e madhe e humbur, e cila do të ishte rikuperuar me një proces krejt tjetër, me një proces konsensual. Faktin që kjo kohë është humbur, na e thotë Komisioni i Venecias. Diku në fillim të raportit të tij, Komisioni i Venecias thotë se shumë gjëra janë bërë mirë, por tani po ju them edhe nja 138 paragrafë rreth asaj çfarë nuk shkon. Kjo është shumë e madhe, kjo është e papranueshme edhe politikisht, sepse po ia thotë Parlamentit të Shqipërisë e askujt tjetër. I thotë: “merreni dhe ribëjeni punën!”

Sigurisht, kanë edhe dozat e ironisë brenda, por kjo nuk ka rëndësi. Fakti është se kemi një produkt që duhet ribërë. Tani ka dy elementë. Kur Komisioni i Venecias thotë: “merreni dhe zbërthejeni sistemin, se e keni të ngatërruar aq keq, sa që nuk dihet se ku del, dhe ribëjeni” ka dy gjëra:

E para, duhet ribërë e tërë anija, se kështu mbytet.

E dyta, i rikthehen palët në nivel të barabartë, për të marrë pjesë politikisht dhe teknikisht në zgjidhjen me konsensus dhe me cilësinë më të lartë teknike, që të gjithë ekspertët tanë kanë, pa pikën e dyshimit.

Pse e them këtë? Sepse në këtë gjashtëmujorin e humbur patëm një garë për t'i ikur opozitës çdo ditë. Dhe këtu nuk e kanë fajin ekspertët. Këtu, në fakt, fajin e ka maxhoranca, e

cila kërkonte ta udhëhiqte procesin në këtë formë, edhe pse ky komision është paritar. Përtej historisë së dopiovotës së kryetarit, që në këndvështrimin tim është antikushtetues – kështu mendoj unë, por ky është vetëm mendimi im – besoj se fakti që Parlamenti na ka dhënë paritet anëtarësie, tregon se ne do ta bëjmë bashkë. Jo t'i ikim njëri-tjetrit, dhe sapa shfaqet dikush te dera tjetër, del nga dritarja. Kjo ka ndodhur gjashtë muaj, dhe certifikatën na e dha Komisioni i Venecias në dhjetor. Na tha, praktikisht i tha maxhorancës: e keni bërë aq keq, sa që do të riktheheni edhe një herë në punë.

Ende jam duke folur vetëm për procesin, dhe e bëj këtë sepse procesi është themelor, është po aq i rëndësishëm sa një substancë e bërë mirë. Unë besoj se eksperiencia e shumë prej nesh, por edhe eksperiencia e ekspertëve, është se një proces i keq ka shumë pak shanse të garantojë një produkt të mirë. E kundërta ka shanse shumë më të larta, që produkti në fund të jetë jo vetëm i mirë, por i gjithëpranuar, gjë që është shumë e rëndësishme.

Por a mund të ndodhte ndryshe? Ne gjykojmë se jo vetëm objektivi politik i kësaj maxhorance, dhe në mënyrë specifike i Kryeministrit, është kapja e sistemit të drejtësisë. Në llogari të fundit, ne gjykojmë se gjëja më e rëndësishme për këtë Kryeministër është që ai, ministrat e tij, aleatët e tij, kushdo tjetër që ai ka interes, nesër të mos ulet në bankën e drejtësisë dhe të japë llogari. Kjo është kapja që i intereson atij. Bëjmë para sot, dhe nesër askush të mos na çojë në burg.

Sigurisht që korrupsioni në administratë, në politikë dhe në gjyqësor, është i jashtëzakonshëm, është në nivelet e skandalit, dhe askush nuk mund ta pranojë. Pikërisht, për shkak se shqiptarëve u janë hapur sytë kohë më përpara, politika nuk ka asnjë rrugëdalje nga bërja e kësaj reforme në drejtësi mirë dhe shpejt. Pra, ne do ta bëjmë këtë, po për fat të mirë ka deklarim të të gjithëve se po, ne të gjithë e duam. Në fund do të dalë se kush e do dhe kush e do keq.

Për fat të keq procesi i bërë gabim me qëllim nga maxhoranca, i ka vënë edhe ekspertët në hall, sepse unë jam i sigurt se mund të bënim diçka tjetër nëse do të uleshim dhe do të diskutonim ndryshe. Prova për këtë, ky parlament ka. Nuk është se s'ka prova. Të paktën në dhjetë, pesëmbëdhjetë vjetët e fundit.

Po a mund të ndodhte ndryshe, në qoftë se Kryeministri, në fjalën e tij inauguruese, në shtatorin e 2013-ës, thotë – po jua citoj: “Është bindja ime e hershme, që në një vend që qeveriset

keq – dhe kemi dy vjet të kaluara keqqeverisjeje – është e kotë që t’i drejtohesh gjyqtarit dhe prokurorit, ndaj ju premtoj se unë do të jem i drejtë”.

Pra, mos u merrni me gjyqtarët e prokurorët! Jam unë gjyqtari! Në fakt kjo po ndodh. Do ta analizojmë pak më poshtë. Shumë shpejt, nëse ky propozim merr aprovimin, nuk do të ketë gjyqtarë dhe prokurorë. Bie, bëhet bosh, zbrazet e tëra, dhe pastaj, pas një periudhe kaosi do të kemi një magjistraturë me ngjyrë politike.

E citova Kryeministrin, për të thënë nëse kishte mundësi ky formacion parlamentar dhe çdo lloj ngrehine ekspertize, t’i qëndronte këtij lloj vullneti, të paktën në fazën e parë, pra, të shkonte e të përplasej me murin. Për fat të mirë, ky muri i Venecias është i fortë.

Pastaj të marrim pjesët, t’i rigrumbullojmë e t’ia nisim edhe një herë nga fillimi. Unë besoj se nuk kishte shans. Tentativën për t’u përplasur me murin e për ta thyer murin, do ta bënte maxhoranca. Dhe e bëri.

Më datën 21 dhjetor Komisioni i Venecias tha: ja ku e keni! Merreni pjesë-pjesë, ribëjeni!

Unë nuk dua të zgjatem më tej me procesin. E vetmja garanci për të ecur, është që ne ta bëjmë këtë punë me proces. E vetmja garanci që ne ta bëjmë saktë, është që ekspertët sot të marrin detyrën dhe udhëzimet, edhe në sy të partnerëve ndërkombëtarë, të cilët, për fat, i kemi, dhe ta reflektojmë së bashku, ashtu siç u ra dakord më 9 janar të këtij viti. U ra dakord që ekspertët do të punonin mbi një draft unik, me konsensus dhe vetëm mbi rekomandimet e Venecias.

Kjo nuk ndodhi. Kjo u prish. Arsyet mund t’i gjejmë te çdo lloj forme, por çështja është që, pa e bërë kështu, nuk ka asnjë shans që në fund fare të kemi një produkt që të jetë i pranueshëm dhe njerëzit të ngrenë dorën e ta votojnë këtë projekt. Pra, është mirë të rikthehemi pak dhe t’i bëjmë gjërat si duhet, përndryshe kjo do të na kushtojë edhe kushedi sa kohë tjetër.

Është fat i madh i yni, që kemi tre elementë, katër në fakt. Kemi opinionin publik shqiptar, që kërkon drejtësi tjetër, jo këtë drejtësi që kemi sot. Të gjithë ne, në veshjen tonë prej qytetari të thjeshtë, na intereson një drejtësi tjetër. Qoftë ata që janë sot në maxhorancë, ne në opozitë, ju që jeni këtu në kapacitete jopolitike, e të gjithë ata që na dëgjojnë në këtë moment, duam një drejtësi tjetër. Kjo është më e rëndësishme se ajo që tha kolegu Majko, se ne e bëjmë këtë për Bashkimin Europian. Në fakt, ne e bëjmë edhe për Bashkimin Europian, por kjo qëndron. Unë besoj se ëpr pesë apo dhjetë vitet e ardhshme, kur neve ende do të jemi duke

trokitur në dyert e bashkimit European, mundësisht duke filluar që nga nesër duhet të kemi një drejtësi ndryshe.

Në çfarëdo lloj gjëje që të ndodhë, në ëndrrën tonë evropiane na duhet një drejtësi ndryshe. Kështu që është fat i madh që kemi *benchmark-e* të përcaktuara nga Brukseli, që kemi ekspertizë e standarde të përcaktuara qartë Komisioni i Venecias, nga Këshilli i Europës, dhe është fat i madh që kemi edhe ekspertizë, edhe presionin e madh të partnerëve të tjerë, gjë që është shumë e dukshme, shumë me vlerë dhe e frytshme, në mënyrë të posaçme nga Shtetet e bashkuara të Amerikës.

E gjithë kjo është një miksturë, e cila nuk i lë shans askujt, në politikë apo jashtë politikës, përfshirë edhe sistemin e drejtësisë, të guxojë të kundërshtojë një reformë, e cila çon në një drejtësi që është e aksesueshme, transparente, e pastër nga korrupsioni, e thjeshtë, e besueshme, që funksionon në mënyrë eficiente, dhe që është e pahapur politikisht.

Këtë duan shqiptarët. Këtë deklarojmë se duam të gjithë ne, por nuk ndodh ndryshe nëse s'bëhet si duhet. Nuk mund të hyj e të analizoj këtu të gjithë elementët që nuk janë trajtuar. Madje haptazi nuk janë trajtuar nga rishikimi i draftit pa u autorizuar nga komisioni, që madje sot ekspertët kërkojnë që ne t'ia çojmë Komisionit të Venecias. Ky komision nuk është një grup kukullash, te i cili kushdo mund të sjellë çfarëdo dhe ne të ngremë dorën. Do t'i marr shembujt, për të thënë që është bërë kështu sepse nuk duhej të bëhej ndryshe, nuk donin të bëhej ndryshe, dhe kjo është drama e këtij procesi, që ndryshe do të kish qenë i suksesshëm.

Në çështjen e kompleksitetit të sistemit, është riparë, është thjeshtuar; për shembull nga inspektorat është inspektor. Unë nuk shoh ndonjë thjeshtim të madh. Thjesht shoh se ka më pak njerëz për të emëruar dhe elementë të tjerë. Në prezantimin që u bë këtu, u tha se nuk mund të fshiheshin institucionet në këtë kompleksin e madh, sepse na deformatoj skema e propozuar. Po cili është problemi? Ejani të bëjmë një skemë tjetër. Sepse pikërisht këtë po thotë Komisioni i Venecias, ky është siluri më i rëndë që i ka lëshuar Komisioni i Venecias këtij drafti.

Paragrafi 10: “Zgjedhjet organizative të propozuara nga projekt-amendamentet, duket se janë tepër të ngathëta (kështu është përkthyer këtu; tani, me këtë çështjen e përkthimit mund të kemi lloj-lloj opinionesh) shumë të rënda, dhe reforma ka gjasa të çojë në një proces vendimmarrjeje shumë kompleks (dhe kjo është kritikë e rëndë) me shumë organe që kontrollojnë njëri-tjetrin, me një sistem të ndërlikuar kontrollesh dhe balancash”.

Një paragraf që është dënim me vdekje, sepse zbërthen gjithë sistemin.

Paragrafi 65: “Kjo skemë e komplikuar institucionale mund të ketë një pasojë të pasynuar, krijon një atmosferë mosbesimi (nuk janë fjalët e mia; unë këto po i them për ata që na dëgjojnë, sepse ne këtu e dimë se për çfarë po flasim), e cila rrezikon të ndikojë vlerësimin publik të gjyqësorit, i cili edhe tashmë është mjaft i ulët. (Pra nuk keni pse ta bëni edhe më keq. E thotë Venecia këtë, pra, preokupohen ata më shumë). Gjithashtu, krijimi i kaq organeve të reja (dhe këtu fillon një dozë ironie shumë interesante, por që në fakt është një e vërtetë shumë e hidhur) do të kërkojë rekrutim masiv të profesionistëve, ndërkohë që numri i kandidatëve që zotërojnë arsimin, trajnimin, përvojën, pavarësinë, mund të jetë disi i kufizuar në një vend kaq të vogël sa ç’është Shqipëria. Komisioni i Venecias do t’i rekomandonte ligjvënësit shqiptar, që të rishikonte ndërtimin institucional të reformës dhe të vendoste nëse numri i organeve që rregullojnë gjyqësorin do të zvogëlohej”.

Pra, Komisioni i Venecias nuk është i shqetësuar nëse deformohet skema e propozuar. Ndryshojeni, thotë, mos u merrni me deformim. Rishikojeni! Ajo që thotë është edhe një tjetër e vërtetë e hidhur. Ne, me kaq shumë institucione dhe me kaq pak njerëz, për fat të keq mund të shkojmë te emrat e përveçëm sot, dhe të marrim vesh kush do të jetë ku.

Kjo është gjë shumë e keqe, sepse edhe sikur ne të jemi me mirëdashje për ta bërë këtë gjë këtu, perceptimi publik ka për të qenë negativ për këtë zgjidhje, do të flasë për kapje. Në mos për kapje politike, për kapje interesash. Askush nga ne nuk e ka luksin për ta pranuar këtë gjë.

Kur ne themi se skema e komplikuar është mekanizmi kryesor për kapjen e sistemit – ja ku e ka thënë edhe me fjalë të tjera Komisioni i Venecias – sepse është rruga më e mirë për të arritur, por duke krijuar idenë sikur po bëhet një gjë e madhe.

Unë do të citoj një shprehje të një personazhi, që në fakt është shumë i njohur në Shqipëri, ndonëse nuk është shqiptar. Shprehja e tij është: “Çdo gjë që është e komplikuar, nuk është e dobishme, dhe çdo gjë që është e dobishme është e thjeshtë”. Këtë test kaq të thjeshtë, kjo skemë nuk e arrin.

E parë kjo bashkë me atë që ne e quajmë rekomandimi 55 apo paragrafi 55 i Komisionit të Venecias, aty pastaj gozhdët mbi qivur janë të sigurta. Pra, nuk ka më asnjë shans për të pasur një sistem, i cili do të jetë i pakapshëm nga politika. Pse? Sepse e thotë Komisioni i Venecias. Po i citoj fjalët, që të mos perifrazoj asgjë unë:

“Aty ku kërkesa për supershemicën prezantohet me nismën e një grupi politik, që e ka këtë supershemicë, ky rregull, në vend që të sigurojë pluralizëm dhe ndarje politike të organit rregullator (pra e pranon edhe Venecia, që mund të ketë edhe ndarje politike brenda organit rregullator), në fakt çimenton ndikimin e këtij grupi të veçantë brenda organit rregullator”

Pra, jo vetëm kaq, jo vetëm e kap, por e çimenton, sepse e mbron këtë ndikim nga erërat politike që ndryshojnë.

Pra, kush bën investim sot në drejtësi, investon për 20-30 vjetët e ardhshme për të pasur Magjistraturën e së majtës, siç thonë italianët, sepse e kanë vuajtur përpara nesh me sa duket.

Tani, t’i mësojmë dy gjëra, i kemi edhe të shkruara, pse duhet ta bëjmë ne këtë gabim? Pse ky komision duhet ta bëjë këtë gabim? Jemi në kohë për t’i dhënë udhëzimet dhe askush nuk na shtyn dot ne që, për shkak të një nxitimi, të përlumen.

Do të kap edhe një element tjetër për ta mbyllur analizën e elementeve të substancës, sepse këtu është e gjatë, kolegë të tjerë mund të duan të thonë të tjera gjëra, por po e them sërish: këto janë për të treguar që ky rishikim i paautorizuar i draftit nga komisioni bie nën testin e asaj që kërkohet nga Komisioni i Venecias dhe rrezikojmë me shumë të madh që ne të marrim një raport të dytë negativ.

Neni 179/b është shumë interesant, i cili praktikisht u thotë shqiptarëve: “Në momentin kur ne kemi këtë Kushtetutë të miratuar, ju nuk keni më as gjyqtarë, as prokurorë”. Por nuk po i hyjmë fare asaj historisë që po i prezumojmë këta njerëz si të fajshëm, pra të inkriminuar; si të fajshëm si të korruptuar, si të paaftë. Nuk po i hyjmë fare kësaj. Pra, në qoftë se në një proces normal, dhe atë që u përmend këtu, dekriminalizimi, barra e provës nuk u bie atyre që do të bëjnë kontrollin, por e gjithë barra e provës u kalon gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Unë jam shumë dakord që barrën e provës për asetet e fituara me korrupsion, ne t’ua kalojmë gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar, por jo nëse janë të aftë ose jo; jo nëse janë me integritet ose jo, duhet ta provojmë ne edhe gjyqtarin, edhe prokurorin në detyrë, pasi t’ia kemi provuar këtë, t’i dërgojmë në shtëpi, nëse është e nevojshme, edhe në burg. Por jo t’u themi: ju sot ikni. Jeni konsideruar të pushuar të gjithë, pavarësisht gabimit në përkthim (në fakt, e njëjta gjë vazhdon edhe në përkthimin korrekt) dhe ne do t’ju zëvendësojmë; do t’ju zëvendësojmë pas një kohe të caktuar si ta gjykojmë ne, me filtrat që ne do të vendosim këtu në Kushtetutë dhe me ligjet me shumicë të cilësuar që ne kemi, si dhe me njerëzit që ne do të vëmë me shumicë e cilësuar. Kjo do të ndodhë. Pra, me hyrjen në fuqi të kësaj Kushtetute, nuk ka më gjyqtarë dhe

prokurorë, për më tepër do të ketë një kolaps në sistemin e drejtësisë shqiptare. Do të turremi me vrap të miratojmë se po na mbeten shqiptarët pa çështje gjyqësore. Pse? Cili është ky nxitim që na jep këto lloj zgjidhjesh që janë të jashtëzakonshme? Unë nuk besoj se ka shkuar njeri në këtë lloj udhe.

Nuk jemi një shtet që po thelemohet sot dhe po ribëhet sot nga e para. Ne po reformojmë. Reforma nuk është tërmet, si ai që thotë Kryeministri. Tërmeti vetëm shkatërrim sjell. Reforma është punë burrash dhe grash me mend, të cilët një gjë që ishte jo mirë e rikthejnë në diçka që funksionon. Në fakt, kjo nuk ndodh. Pra, ne i japim mundësinë sot që ata që kanë pushtetin, ata që kanë tre të pestat, ta mbushin gjyqësorin me të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që ata duan dhe preferojnë, madje-madje shkon deri aty sa nuk ka asnjë kufizim në kohë. Mund të vijnë edhe ish-gjyqtarë ose ish-prokurorë të shkarkuar, të kohës së komunizmit, nuk ka rëndësi, mund të futen, sepse bëjnë një vit shkollë Magjistrature dhe e kalojnë testin.

Nëse ne nuk ua themi shqiptarëve disa të vërteta kaq të hidhura, që ka edhe të tjera, ata nuk do ta kuptojnë diskutimin tonë. Siç duket, lumë fjalësh përplasen në cep; po të njëjtën histori kanë këta. Por ne nuk mund t'ia lëmë këtë zullum të madh nga pas. Pse? Unë besoj dhe për këtë jam i sigurt, se ky sistem, nëse kalon kështu siç është, do të kërcasë, por do të kërcasë dhe do të thyhet brenda 5 deri në 10 vjet dhe brenda pesë dhe dhjetë vjetësh ne do të jemi përsëri duke diskutuar këtu. Ndoshta ne që jemi këtu jo, por të tjerë që do të na zëvendësojnë do të jenë duke diskutuar të njëjtat gjëra.

Nuk e bëjmë dot në vitin 2000, me sa duket, siç duhej dhe po e bëjmë prapë keq në vitin 2015.

Cili është ky vend që ka luksin të përballojë kosto kaq të mëdha sa të ridiskutojë çdo 10-15 vjet reforma drastike si këto në drejtësi?

Jo vetëm kaq, por duke e mbyllur, unë besoj se nëpërmjet këtyre rreth 67 neneve kushtetuese, në fakt, është diçka e jashtëzakonshme, ne gati-gati po rithemelojmë Republikën ndryshe. Është një ndërhyrje masive, gjigande, e ashpër, gati-gati në disa pika është brutale, mbi strukturën dhe arkitekturën e Kushtetutës pa marrë parasysh se kjo kolonë e pushtetit do të ndërveprojë dhe eventualisht do të krijojë tension për pjesën tjetër të funksionimit të Kushtetutës.

Po jua them shumë shpejt me dy fjalë dhe do ta mbyll: një Kryeministër, i dizenuar si një Kryeministër i fuqishëm brenda ekzekutivit, jo jashtë ekzekutivit, i cili ka hequr mandatet e

deputetëve, ministrave të tij dhe jo pak, pra nuk ka një kontroll politik të brendshëm nga forca e tij politike.

Unë të çoj nesër në shtëpi si nxënës shkolle. I ka zëvendësuar këta me deputetë të tjerë që nuk i thonë gjë, përveç problemit të kriminalizimit, që e kemi diskutuar dhe e kemi mbyllur besoj diskutimin për këtë, është një Kryeministër i pakontrollueshëm nga politika dhe me një sistem drejtësie, që, siç thotë Komisioni i Venecias, është në një gërr-mërr të vazhdueshëm me veten e tij, në vend që të shohë ç'po bën Kryeministri me tenderët, ky Kryeministër kap sistemin e drejtësisë dhe nuk ka shans që sistemi i drejtësisë ta vërë atë para bankës. Nuk do të ketë nevojë as për të marrë gjyqtarin në telefon dhe për ta kërcënuar: “Unë të pres këmbët në qoftë se ti më vendos ndryshe”!

Faleminderit, zoti kryetar!

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zonja Hysi.

Do të ishte më mirë, në fakt, që të ishim më konçizë, por, gjithsesi, secili nga kolegët ka të drejtën e fjalës. Unë nuk kam gjë tjetër, veçse ta moderoj këtë tavolinë.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Para së gjithash, më lejoni të falënderoj të gjithë ata burra dhe gra që, në fakt, nuk kanë bërë ndonjë zullum, por kanë qenë ekspertë të nivelit të lartë, vendas dhe të huaj, të cilët kanë kontribuar për të sjellë një produkt, të cilin Komisioni i Venecias e ka vlerësuar!

Më lejoni të citoj se çfarë thotë në përfundimet e tij Komisioni i Venecias: “Komisioni i Venecias shpreh mbështetjen për përpjekjet e autoriteteve shqiptare për reformimin tërësor të sistemit...” dhe thotë: “Projekt-amendamentet paraqesin një bazë solide pune të mëtejshme në këtë drejtim”. Pra, nuk thotë që dokumenti i punës ka 138 vërejtje.

Ju lutem, është mirë, meqenëse jemi profesionistë, sot para publikut të flasim realisht për ta lexuar mendimin e Komisionit të Venecias, rekomandimet, sqarimet dhe modelet që ofron ashtu siç janë.

Në fakt, dëgjova nga kolegët e opozitës se nuk duhet nxituar, kemi kohë. Kjo bie në kundërshtim me atë çfarë thuhet në përfundimet e raportit.

Vetë Venecia thotë se reforma është urgjente dhe gjendja e sistemit të drejtësisë e justifikon që reforma të jetë radikale. Për këto të dyja kemi rënë dakord. Ndaj, nëse duam ta shprehim qartë pozicionin tonë si ekspertë, si parlamentarë, që me konsensus vendosëm të

qëndrojmë jashtë këtij procesi dhe që në vendimet e para ua besuam këtë proces ekspertëve për dy arsye, së pari, jemi ne politikanët që kemi bërë gjynahe me sistemin e drejtësisë, sidomos në këto 25 vjet.

Së dyti, jemi ne politikanët, funksionarët, zyrtarët e lartë, të cilët jemi në konflikt interesi pasi kjo reformë të përfundojë.

Po flasim për një sistem ku sundon pandëshkueshmëria, ku deri sot gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë zgjedhur me 36 vota dhe ne sot kërkojmë t'i zgjedhim me 84 vota.

E dyta, nuk do t'i zgjedhim ne, por vetë gjyqtarët dhe prokurorët, dhe ne kemi një numër tej mase të limituar të personave që do të zgjidhen nëpër strukturat e sistemit të drejtësisë.

Deri sot asnjë nga kolegët e maxhorancës, sidomos të Partisë Socialiste, nuk ka marrë pjesë në debatet publike. Kemi preferuar të heshtim, sepse kemi respektuar atë konsensus politik që u vendos kur parlamenti votoi vendimin për ngritjen e këtij komisioni: fjalën do ta kenë ekspertët. Të paktën një herë në këto 25 vjet reformën ta bëjnë ekspertët. Jo se nuk dinim edhe ne të flisnim dhe të shprehnim opinione, madje edhe të prananim ftesat e gazetarëve në studio, por mendojmë se po të futeshim ne, politikanët, do ta prishnim këtë proces. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që nuk ka pasur dialog dhe konsensus politik.

Më lejoni shumë shkurt t'ju përmend sesa dialog kemi bërë për të gjithë metodologjinë që u ndoq në këtë proces. Meqenëse kolegët përmendën këtu Komisionin e Dekriminalizimit, do t'ju lutesha, meqenëse pjesa më e madhe jona kemi qenë anëtarë të këtij komisioni, nuk duhet të bëjmë krahasim midis komisionit *ad hoc* të ngritur për dekriminalizimin ose për integritetin e institucioneve dhe Komisionit për Reformën në Drejtësi. Janë si dy pika që nuk ngjajnë me njëra-tjetrën.

E vetmja pikë e përbashkët është që gjetëm konsensus që t'i referohemi Komisionit të Venecias paraprakisht para se të hynim politikisht.

Por kur vjen puna te produkti, më falni që do t'ju them, por ne produktin e morëm minutin e fundit. Pra, nuk pati ndonjë konsultim e dialog, siç pretendoni ju sot, ndërkohë që ne sot, si deputetë, si anëtarë të këtij komisioni kemi qenë të pranishëm, të ftuar në të gjitha tryezat e konsultimit publik, në debatet; kemi pasur një *website* në dispozicion, kemi pasur dokumente pune në dorë të printuara, ka një historik, ka një regjistrim, të cilat ne mund të gjykojmë t'i

vlerësojmë, por brezat që do të vijnë pas nesh, që do të ulen në këto ambiente do ta vlerësojnë më shumë.

Nga ana tjetër, thuhet se ka nevojë për dialog politik. Po, kemi bërë dialog dhe ka dialog.

T'ju përmend disa momente kur kemi bërë dialog? A e morëm ne bashkë vendimin që dokumenti t'i shkojë Komisionit të Venecias, pra pranuar kërkesën që sollën grupet e ekspertëve? A kemi vendosur dhe a ramë dakord për të gjithë procedurën sesi duhet punuar? Ku është politizimi i procesit dhe mbyllja? Se disa herë nëpër dhëmbë u përmend se ka qenë proces i mbyllur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kush mund ta thotë? Por disa e thanë edhe haptazi.

Cilët janë përfaqësuesit? Ishin përfaqësuesit e Presidencës, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, të institucioneve të arsimit të lartë, të Shkollës së Magjistraturës, të Avokatisë. Pra, ju sot, ndonëse me tone shumë më të buta se herët e tjera, anatemuat për të thënë: “Ekspertët tuaj, ekspertët tanë”.

Për sa i përket tolerancës ose konsensusit politik që kemi bërë, që, me thënë të drejtën, mua më ka dhembur shumë, është se pranuar që ekspertë politikë t'u atashohen ekspertëve të pavarur të Komisionit për Reformën në Drejtësi. Ky ishte konsensus politik.

Për sa i përket procesit, do të desha të ndalem edhe në një moment të fundit. Ju përmendët se ky proces duhet të shtrihet, pra kemi kohë, nuk na ngut njeri, sepse kemi humbur kaq kohë. Në fakt, reforma në drejtësi nuk ka humbur kohë që në momentin që komisioni ose parlamenti konstituoit ngritjen e Komisionit për Reformën në Drejtësi.

Ju, si opozitë, keni qenë të larguar dhe hytë me vonesë. Megjithatë, keni qenë shumë aktivë dhe ju vlerësoj shumë që keni qenë në të gjitha mediet, keni shprehur opinionet, qëndrimet dhe vlerësimet tuaja, pavarësisht se nuk keni pasur mendimin tonë si përfaqësues të maxhorancës përballë jush, për të thënë se disa gjëra që thoshit ishin totalisht të pavërteta. Por të paktën është kjo reformë që ka dëgjuar këto ditë edhe publiku i gjerë, ekspertët e nivelit të lartë, të cilët kanë qenë të pranishëm në medie dhe kanë bërë besoj, të gjithë biem dakord, një prezantim shumë dinjitoz. E kanë prezantuar, përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve, edhe para publikut të gjerë me një gjuhë shumë të thjeshtë, transparente të gjithë këtë proces.

Për sa i përket përmbajtjes që përmendët, gjatë kohës kur po flisnit, u përpoqa të numëroja 138 rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Më vjen keq! Janë 138 paragrafë, por jo rekomandime, sepse në shumicën e rasteve Komisioni i Venecias e vlerëson pikërisht përmbajtjen e kësaj reforme.

Meqenëse përmendët shpesh paragrafin 55, është mirë të heqim dorë nga leximi ndryshe i raporteve të ndërkombëtarëve, që shpesh e bëni edhe ju, edhe ne. Por në rastin konkret ju lexoni pjesën e parë të këtij paragrafi dhe nuk lexoni vazhdimin e tij. Është i vetmi rast që do të doja të përdorja për ilustrim, për të mos e zgjatur shumë: çfarë thuhet pikërisht për vendet që kanë një numër të konsideruar votash të maxhorancës? Ndoshta kjo çështje mund të trajtohet nga legjislacioni zbatues, i cili duhet të sigurojë që propozimet e kandidatëve janë të lira në maksimumin e mundshëm nga diktimi politik. Pra, në paragrafin 55 nuk thuhet se ju duhet patjetër që, për të shpëtuar nga ndikimi politik, të ndryshoni procedurën. Lexojeni, e keni në faqen 16 të raportit të Komisionit të Venecias!

Të nderuar kolegë,

Unë mendoj, sikurse e thanë edhe të gjithë kolegët, edhe zoti Braho, që ndoshta drafti i përgatitur nga ekspertët mund të ketë nevojë për përmirësime, por biem dakord që do të ishte mirë ta dëgjonim edhe një herë Komisionin e Venecias, pra të prananim sugjerimin që bën grupi i ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe më pas të vazhdojmë debatin dhe dialogun tonë.

Ka shumë punë për të bërë, pra ajo për të cilën nuk kemi kohë, që është urgjente, është të marrim opinionin e këtij komisioni dhe më pas grupi teknik i punës dhe ne do të jemi këtu, sepse, përveç miratimit të ndryshimeve kushtetuese, ka një paketë të tërë ligjore që duhet bërë.

Por do të desha ta përfundoj dhe ta bëja të qartë edhe për publikun, pasi deri tani nuk doli në pah: ne si politikanë kemi hequr dorë nga ndikimi politik që ka qenë i pranishëm për 25 vjet në Shqipëri, pavarësisht cila forcë politike ka drejtuar, kush ka pasur maxhorancën.

E dyta, që ne po forcojmë institucionet dhe po respektojmë karrierën.

E treta, është pluralizmi politik që po krijohet për institucionet, sepse nuk e keni përmendur që pjesa më e madhe e institucioneve që do të bëjnë emërimë nuk është e përbërë vetëm nga gjyqtarë dhe prokurorë, por ka edhe anëtarë që vijnë nga jashtë sistemit, çka tregon rritjen ose qytetarët do të ndihen të përfaqësuar nga përfaqësuesit e tyre përballë trupave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, çka ka munguar deri sot, që ka rregulla transparente dhe më shumë parime të shtuara në projektin e dytë që kanë sjellë ekspertët, që ka më shumë qartësi dhe

transparencë dhe nuk do të ndodhë më ajo praktikë që, kur diskutonim kandidatët për në Gjykatën e Lartë, ndërpritej procesi i dëgjësive publike me artifice për t'ia çuar Gjykatës Kushtetuese të na interpretonte se çfarë do të quhej jurist i shquar apo të na interpretonte dispozita që i kishte interpretuar disa herë më parë.

Prandaj, i nderuar zoti kryetar, do të doja edhe një herë të falënderoj shumë të gjithë ekspertët për punën e palodhur, por edhe Sekretariatit Teknik për atë punë voluminoze që kanë kryer! Shumë faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka zoti Strazimiri.

Përgatitet zoti Manja.

Gent Strazimiri – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do t'u drejtohem qytetarëve që po na ndjekin më në fund në të vetmen seancë që u lejua të jepet *live* në këtë komision, për shkak se e shoh krejtësisht të panevojshme t'i drejtohem këtij komisioni.

Siç jua tha kolegja Hysi pak më parë, ky komision, për shkak se Edi Rama nuk do ndikime politike në draft, praktikisht, kryen funksionin e zyrës së postës: ekspertët e pavarur të nivelit të lartë sjellin një draft këtu, të cilin ne nuk mund ta ndryshojmë, sepse ndryshe e bëjmë pis me politikë, por e paketojmë, e noterizon zoti Xhafaj në emër të të gjithëve ne dhe e çon në Venecia. Pastaj, Venecia na kthen përgjigje dhe ne ndoshta, duke qenë se është gjendur vendi i papërshtatshëm, Venecia është e famshme edhe për maskat, mendoj se duhet të fshihen edhe pas maskave. Mendojnë se duhet të fshihen pas maskave që i bëjnë vetë për të konsideruar se janë në linjë me Venecian.

Venecia e kthen këtu te ne qartë, të pastër si kristali, kurse këta bëjnë sikur i kanë reflektuar, e sjellin këtu, paketohet në zyrën postale dhe shkon me postë në Venecia.

Sistemi i sotëm i drejtësisë, të nderuar qytetarë, është një mëkatar i madh i këtyre 25 vjetve të demokracisë. Ne e dimë të gjithë, por, në fakt, është pasqyrë e asaj që ka qenë politika në këto 25 vjet. Nuk është hera e parë që politika bën histori me sistemin e drejtësisë, është praktikisht hera e dytë. Herën e parë e ka bërë, po ashtu, me një maxhorancë të cilësuar, të dalë nga zgjedhje të pranueshme për momentin në vitin 1997. Më 5 gusht të këtij viti, në pikë të vapës, muaj pushimesh, Ministri i Drejtësisë Thimjo Kondi, urdhëron gjykatat të marrin një muaj pushim të detyruar.

Gjatë asaj kohe thërret të gjithë drejtorët e Ministrisë së Drejtësisë dhe i detyron të japin dorëheqjen, ashtu sikurse 30 prokurorë të Republikës, përfshirë kryetarin e Prokurorisë së Tiranës dhe zëvendësin e tij.

E gjithë kjo stratagjemë, gjatë 30-ditëshit që gjykatat janë pushim, ishte që këtyre t'u skadonte edhe afati për të ndjekur rrugën ligjore kundër shkarkimit.

Në datën 27 gusht Presidenti i Republikës, i zgjedhur nga kjo maxhorancë e cilësuar, në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, propozon në kuadër të reformës një ndryshim ligjor shumë të rëndësishëm: Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili deri në atë moment përbëhej nga 70% e anëtarëve të zgjedhur nga gjyqësori dhe vetëm 30% e anëtarëve, të zgjedhur nga parlamenti.

Me ligj bëhet 70% e anëtarëve të zgjedhur nga parlamenti dhe 30% e anëtarëve të zgjedhur nga gjyqësori.

Miratohet ky ligj në parlament dhe parlamenti zgjedh anëtar krejtësisht apolitikë: avokatin e Fatos Nanos, Përparim Sanxhakun, Dashamir Koren, ish- ministër i Drejtësisë në kohën e komunizmit dhe lexohet teksti që e dëgjojmë akoma sot: “Në 100 ditët e para, Kryeministri Fatos Nano e quajti këtë arritjen më të madhe të qeverisë, kontribut historik në të mirë të atdheut dhe të pavarësisë së sistemit të drejtësisë.” Burimi është Grupi i të Drejtave të Njeriut (British Helsinki Human Rights Watch), i cili e ka fotografuar situatën.

Duke qenë se e gjithë kjo është një film, që e kemi parë një herë, dhe të gjithë jemi dëshmitarë se sa shumë është përmirësuar puna e gjyqësorit nga kjo reformë historike e vitit 1997, e drejtuar nga Fatos Nano dhe Thimjo Kondi;

Duke qenë se nga vitit 2005 deri në vitin 2013, kur e la pushtetin, asnjë forcë tjetër politike nuk e ka pasur mundësinë të ketë një maxhorancë të tillë të cilësuar, që t'i ndryshojë gjërat, por ka punuar me produktin, që i la reforma historike e Fatos Nanos në vitin 1997, arrijmë në konkluzionin se këta që po flasin sot për reformë historike, nuk mund ta bëjnë, por janë shkaktarët e asaj që ka ndodhur.

A do të ishte sigures fakti që, siç tha zonja Hysi, ekspertët janë të gjithë të pavarur?

Zonja Hysi, deri ditën kur u bëre kreu i listës së kandidatëve të PS-së së Tiranës, unë të dija të pavarur, të dija veprimtare të të drejtave të njeriut.

Koncepti i pavarësisë në këtë vend, veçanërisht, kur vjen puna për politikën, është shumë fluid. Mbi atë nuk mund të ngresh një kështjellë apo diçka historike. Ndoshta për këtë arsye, degjenerojnë gjërat gjatë rrugës këtu te ne.

Më lejoni t'ju kujtoj, se ditën që ka nisur reforma për drejtësi si një aspiratë, aspirata kishte 140 vota, nga 140 deputetë, që ka parlamenti. Të gjithë ishin të mendimit se duhej reforma.

Drafti i qeverisë, i cili shkoi i pari në Komisionin e Venecias, u reduktua në një mbështetje prej 87 votash, domethënë votat e pushtetit.

Drafti aktual, ju e dëgjuat të gjithë, se folën përfaqësuesit e të gjitha forcave politike, i cili pretendohet të shkojë përsëri në Komisionin e Venecias, është reduktuar në 62 vota të vetëm njëerës prej partive të maxhorancës qeverisëse. Ky është një reduktim dramatik i konsensusit mbi mekanizmin, jo mbi aspiratën e reformës për drejtësi. Askush nuk është i bindur që ky mekanizëm që po prodhohet këtu, do të sjellë diçka më të mirë se reforma historike, që bëri Fatos Nano dhe Thimjo Kondi, të cilën jua përmenda pak më lart.

Aktualisht, jemi të gjithë në siklet, edhe ne që nuk kemi marrë pjesë në këtë draftim, por e kemi lejuar këtë draftim, ndodhemi në siklet para një dokumenti të tillë, i cili sapa na u dha këtu dhe që për mendimin tim, nuk është përkthim jokorrekt. Komplimente për përkthimin, por është një qëllim jokorrekt dhe kjo është e qartë. Nga pikëpamja sasiore është 2-fishi. Janë shtuar fjali ndaj atij që quhej përkthim korrekt.

Për më tepër, kur mendoj që dokumenti nuk prodhohet në anglisht dhe më pas të përkthehet në shqip. Ai është një dokument i prodhuar në shqip, nga ekspertë shqiptarë, i cili sigurisht përkthehet në anglisht për të huajt.

“Jashtë ndikimeve politike”, tha zonja Hysi. Edhe ne prandaj nuk kemi marrë pjesë.

Kryeministri po ashtu, e gënjeu opinionin publik, sipas mendimit tim, kur tha se nuk e kishte lexuar fare draftin, se nuk i interesonte ai. Një Kryeministër që e konsideron qëllim në vetvete të çdo sekonde të qeverisë së tij se po bën historinë, atë faqe të historisë që po bën vetë, do të duhej të kishte marrë mundimin ta lexonte, madje edhe të debatonte për të, pa e bërë pis politikisht.

Jo, sikurse të gjithë kolegët e nderur të maxhorancës në pushtet, thonë se nuk e kanë lexuar, se sapa u erdhi dhe se e kanë bërë ekspertët.

Ndërkohë, këtu përpara kemi mediat që lajmërohen 6 ditët e fundit, se te vila 30 do të bëhet një takim për punën e reformës. Nga kush? Nga ekspertët? Jo, nga drejtuesit politikë në pushtet të këtij vendit. Lajmërojnë mediat se do të takohen për reformën, ndërkohë që nuk merren me të, por presin se ç'po bëjnë ekspertët.

Kryeministri ka dalë sot dhe ka thënë se konsensusi është pazar dhe ai nuk merret me pazaret. Konsensusi është një marrëveshje, e cila ka edhe vendin e vet institucional ku duhet bërë. Kjo duhet të bëhet në parlament.

Çdo lloj marrëveshjeje tjetër që nuk bëhet në parlament, është pazar. Ku zgjedhin ta bëjnë këtë? Zgjedhin ta bëjnë te vila 30, vendi ku në vitin 1981 vetëranë M. Shehun. Vila 30 në mes të Tiranës, në një farë mënyre në këtë vendin tonë heroik, është kështjella e Makbethit, ku ndodhin gjëmat historikisht. Në kështjellën e Makbethit, në mes të Tiranës, mbliidhen për reformën, por nuk e diskutojnë politikisht, se nuk e kanë idenë se çfarë bëhet me reformën.

Unë mendoj se është mirë për të gjithë ne, t'i japim fund kësaj farse, se e tillë është. Kjo farsë po zhvillohet kudo, në çdo skutë, me çdo lloj mjete presioni, përveçse në parlament, përveçse me transparencë, përveçse duke parë të gjithë bashkë, edhe në sytë e publikut, rekomandimet e Komisionit të Venecias, të cilat janë shkruar qartë, e zeza në të bardhë. Komisioni i Venecias nuk ka pasur maskë. Ai ka qenë krejtësisht i qartë.

“Jo, do të bëjmë një maskë tonën, që të mbërrijmë te ajo që duhej të bënim dhe që mund ta bëjë vetëm qeveria, sepse qeveria është mbështetja e këtij drafti sot për sot, jo e gjithë maxhoranca (siç e patë).

Nëse ekziston pushtet gjyqësor në një sistem demokratik, ekziston vetëm që t'i japë mundësi të pamundurit, të pafuqishmit, përballë pushtetit, përballë qeverisë.

Nëse edhe drejtësinë ta jep qeveria, do të thotë që gjithçka është e kotë.

Të nderuar qytetarë,

Në këtë rast, pavarësisht nga maskat që vendosen veneciane, apo jo, po përgatitet njësoj, si në vitin 1997, drejtësia e qeverisë. Këtë nuk duhet ta lejojmë dhe kjo nuk është vetëm çështje e opozitës, por është çështje e të gjithë qytetarëve nga i pari deri tek i fundit, sepse njësoj si tek mjeku kur sëmuremi të gjithë, edhe te drejtësia, edhe në gjykatë, shkojmë të gjithë njësoj.

Nëse sot në spital ai që ka para mund të blejë jetën, nesër në gjykatë, të gjithë, nga i pari deri te i fundit, do të marrin thjesht, atë që do Kryeministri, ky që është sot, edhe nëse nesër nuk është më në pushtet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Manja!

Më pas, e ka fjalën zoti Ristani!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se qëndrimin politik dhe shtrirjen e dorës për konsensus për këtë reformë madhore për shqiptarët, e dha kolegu Majko dhe më mirë se ai, unë nuk di t'i lidh fjalët për konsensus politik, por si ish-prokuror dhe si përfaqësues i zgjedhur sot me votat e popullit, do të doja mirëkuptimin e ekspertëve dhe të kolegëve të mi, që të flas pak më gjatë se dua ta dëgjojnë shqiptarët dhe në këtë rast, besoj se më kuptojnë ata, që kanë nevojë për reformën.

Një shprehje e urtë popullore jona thotë: “Kur të ulesh për të zgjidhur një hall, mos i beso fort të diturit, se i dituri e ka me të lexuar, por besoji të vuajturit, se ai e heq në kurriz çdo ditë.”

Ata që po e vuajnë sot në kurriz këtë korrupsion për të cilin të gjitha palët politike i thanë përfaqësuesve të Komisionit të Venecias kur erdhën në Tiranë: “Po, në drejtësi ka korrupsion dhe opinionin e përgjithshëm të popullit, është që nuk shkon më kjo gjendje në drejtësi”.

Përveç popullit, i cili po e vuan në kurriz këtë sistem drejtësie çdo ditë, po e vuajnë në kurriz edhe shumë gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të ndershëm të këtij vendi, të cilët janë të detyruar sot të rrinë në një ambient të pistë, kur në fakt punojnë nga mëngjesi deri në darkë me përkushtim për të respektuar Kushtetutën dhe ligjet e këtij vendi.

Kur i dëgjoj kolegët e mi të opozitës në këtë tryezë shumë të respektuar, të krijohet ideja se sistemi i drejtësisë sot në Shqipëri paska një pronar dhe ai janë këta, dhe ne, pjesa tjetër në anën tjetër të tryezës, paskemi bërë apo po tentojmë të bëjmë një draft nën maskën veneciane të grupit të ekspertëve të pavarur, që në gjykimin tim, i kanë bërë nder këtij procesi, dhe duam ta marrim.

Jo, të nderuar qytetarë shqiptarë, ne nuk duam të jemi pronarët e sistemit të drejtësisë në Shqipëri as për 20 vjet, as për 30 vjet, por nuk mund të pranojmë që shqiptarët të vuajnë një magjistraturë të djathtë, as nuk jemi për të vuajtur një magjistraturë të majtë.

Ju, të nderuar qytetarë shqiptarë, meritoni një magjistraturë, siç e ka përcaktuar Kushtetuta dhe ligjet e këtij vendi dhe për këtë jemi ne sot këtu dhe po ta lexoni draftin e punuar

nga ky grup ekspertësh, jo me syze të errëta dhe pa paragjykime politike, ashtu siç përpiqem dhe e kam lexuar unë, si ish-prokuror, po ju them se edhe sikur t'ju jepej për ta shkruar juve këtë draft dhe t'ju thuhej të gjenit një variant, ku politika të ketë një ndikim sa më minimalist mbi sistemin e drejtësisë, më mirë se ç'është hartuar, nuk mund ta hartonit dhe për këtë jam i bindur.

Meraku që kam unë, është nëse do të gjendet konsensusi politik për ta votuar këtë draft, a do të jemi në gjendje si parlament dhe si njerëz të ligjit, që ta implementojmë deri në fund këtë draft, sepse ky draft e çliron sistemin e drejtësisë nga kapja politike që ka sot.

Tani të hyjmë më konkretisht në terrenin, që po diskutojmë.

Kolegu Halimi tha: “A keni dëgjuar ta kundërshtojmë mekanizmin antikorrupsion, që ka drafti? Jo, por problemin me korrupsionin e ka qeveria, e ka Kryeministri Rama.”

Mirë, të nderuar qytetarë shqiptarë, si ka mundësi që problemin me korrupsionin e paska qeveria, e paska Kryeministri, i cili ka dhënë të gjithë mbështetjen dhe ka pasur vullnetin e duhur politik për këtë draft të ndryshimeve kushtetuese?

Atëherë, zoti Halimi këtu meritohet të thuhet një fjalë e mirë edhe për qeverinë, edhe për Kryeministrin, i cili i jep suport krijimit të këtyre institucioneve antikorrupsion, që ka ky draft. Le ta miratojmë dhe të shohim, si do të sillemi në raport me ligjin.

E dyta, thotë se është dakord me procesin e pastërtisë së figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve ose lustracioni karshi pasurisë, lidhjeve me krimin dhe aftësive profesionale, por thotë se ata që do ta bëjnë këtë proces, nuk duhet të jenë të qeverisë, por duhet të jenë të PD-së.

Po ta lexosh draftin, ai ka dhënë një mekanizëm perfekt një proces transparent, që nis me Avokatin e Popullit, vjen në Kuvendin e Shqipërisë për t'u votuar me 3/5 e votave, por ç'rëndësi kanë 3/5 apo 2/3, sepse ky draft nuk është shterues dhe do të shkojë në Venecia për të marrë një mendim.

Në fund fare, nëse Kuvendi nuk vendos brenda 30 ditëve, ditën e 35-të Presidenti i Republikës zgjedh nga lista komisionerët e të dy trupave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. As këtu nuk kemi dorë ne, sepse ne nuk duam ta kemi në dorë drejtësinë. Atë duhet ta kenë shqiptarët.

Ajo për të cilën nuk bihet dakord, thotë kolegu Halimi, është organizimi i pushtetit gjyqësor në RSH, sipas draftit të propozuar, sepse këtu vjen një skemë, ku qeveria dhe posaçërisht, Kryeministri i një force politike, që sot në parlamentin shqiptar, partia që ai përfaqëson (PS-ja), ka 65 mandate.

Si mund ta kapë sistemin gjyqësor Kryeministri me 65 mandate? Kur në fakt që 3/5 bëjnë 84 dhe unë e di që ky është një numër i ndryshëm nga numri 65.

Unë nuk e di si mund të kapet sistemi i drejtësisë, kur Këshilli i Lartë Gjyqësor, që do të jetë qeveria e gjyqësorit, në shumicën vendimmarrëse do të jetë me 6 gjyqtarë dhe 5 jogjyqtarë?

Unë nuk e di si mund të kapet shërbimi i prokurorisë së vendit, kur Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të ketë 6 prokurorë dhe 5 joprokurorë?

Po ç'rëndësi ka kjo? E rëndësishme është që ne kemi arritur konsensusin mes maxhorancës dhe opozitës në një pikë dhe këtë e thotë edhe Komisioni i Venecias në opinionin e ndërmjetëm: "Klasa politike shqiptare me vullnet të plotë bie dakord që Shqipëria ka nevojë për një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë dhe përpjekjet e Shqipërisë në këtë drejtim, janë për t'u lavdëruar."

Ajo ku ne ndahemi është procedura, si do ta bëjmë këtë reformë në sistemin e drejtësisë. Kjo maxhorancë është përcaktuar shumë qartë në vendimin e Kuvendit: "Jemi për një proces parlamentar të reformës në drejtësi". Duke u dakordësuar me këtë vullnet politik, metodologjia dhe rruga që kemi zgjedhur, si komision, është nëpërmjet grupit të ekspertëve. Po të doni i quajini ata të varur, po të doni quajini të pavarur, politika drafton vullnete, por nuk drafton drafte ligjore dhe ky draft sigurisht, është hartuar nga ekspertët dhe kolegët vendas dhe ndërkombëtarë me një seriozitet, që i ka hije një procesi të ndryshimeve kushtetuese, sepse ka gati 1 vit që po punohet dhe po kërkojmë të ndryshojmë rregullat kushtetuese të një pushteti të pavarur, që është pushteti gjyqësor dhe sigurisht, një proces kaq i zgjatur në kohë, si ky që kemi ndjekur si komision, i bën nder këtij procesi.

Këtu dua të vij te kolegu im shumë i respektuar, zoti Bylykbashi. Ai së bashku me zotin Halimi thonë, se nuk e dinë se ku punuan ekspertët. A ka ndonjë shqiptar, që e di se ku punuan ekspertët? Nuk e di.

Unë dua të pyes në ka ndonjë shqiptar, që e di se ku punuan ekspertët e komisionit të ligjit për dekriminalizimin, anëtar i të cilit kam qenë edhe unë?

Unë e di që jemi mbledhur nja 2 herë këtu, por shqiptarët e dinë dhe duhet ta dinë edhe sot nga goja ime, se ky grup ekspertësh ka zhvilluar vetëm gjatë vitit 2015, 42 tryeza konsultimi dhe bashkëbisedimi ditën për ditë, nga mëngjesi deri në darkë, në ambientet e Kuvendit, në universitete, në takime me qytetarët dhe me grupet e interesit. Të gjithë i kanë parë dhe vetëm

këta nuk i shohin, sepse këta, të nderuar qytetarë shqiptarë, quajnë konsensus politik dhe reformë, vetëm kur u duhet këtyre.

Le të më thonë sot këta, nëse vajti ligji “Për dekriminalizimin” dhe paketa e ndryshimeve kushtetuese në funksion të këtij ligji, për të marrë opinionin e Komisionit të Venecias?

Unë nuk e di të ketë vajtur. Nuk vajti, sepse kur u duhet këtyre, Kushtetuta ndryshohet në 4 minuta dhe 38 sekonda.

Kjo është arsyeja për të cilën, unë ndoshta bëra një diskutim pak ndryshe, por përsëri i qëndroj konsensusit politik, sepse Kushtetuta nuk është prona jonë, por është pronë e shqiptarëve. Ajo i do ato të shkreta 94 vota për t’u ndryshuar dhe shumë mirë që ata që e kanë hartuar atë Kushtetutë, e kanë lënë me 94 vota, por ne nuk mundemi, që përmes një të ashtuquajture “republike të ekspertëve”, njerëzve të ditur dhe një republike pazaresh politike në tavolinë, për të bërë një reformë në drejtësi, për të prekur një pushtet kaq delikat për shqiptarët, unë do të isha në anën e republikës së ekspertëve, sepse të diturin mos e pyet, si puna e të vuajturit për të zgjidhur hallin që ke, por mendjen duhet t’ia respektosh, sepse nuk mundemi të shkojmë të ulemi, siç ulem unë dhe Oerdi, 10 minuta këtej, 10 minuta andej dhe hajde të shkojmë të ndryshojmë Kushtetutën. Nuk kam folur besoj sot për t’u mbushur mendjen kolegëve të mi të nderuar se sa i ditur dhe sa jurist i zoti jam, por kam folur, sepse kam 1 vit që kam heshtur, që ditën kur parlamenti shqiptar ngriti Komisionin për Reformën në Drejtësi. Kam heshtur ndoshta dhe kundër dëshirës sime, sepse nga natyra jam njeri që flas vend e pa vend, studio më studio. Kam dëgjuar budallallëqe juridike nga më absurdet. Kam dëgjuar paradokse nga më të ndryshmet. Po sjell një shembull. Për të zgjidhur prefektin e Tiranës duhet të votojë dhe këshilli bashkiak i Tiranës dhe Këshilli i Ministrave. Këto argumente juridike kam dëgjuar unë dhe u janë servirur shqiptarëve prej 8 muajsh për reformën në drejtësi.

Ndërkohë, të nderuar ekspertë, kolegë, cilido të jetë anatemimi që mund t’i bëhet këtij grupi ekspertësh për nevojat politike të ditës, sepse kjo është lojë pushteti, për ne është reformë në sistemin e drejtësisë, për dikë tjetër mund të jetë lojë pushteti politik. Unë jam ndier shumë i lumtur dhe më vjen mirë që kisha heshtur për këtë reformë, deri natën kur kam dëgjuar 4 ekspertët shqiptarë, 4 ish-profesorët e mi. Unë e kam për nder që i kam pasur profesorët e mi. Jam ndier shumë i lumtur dhe krenar për atë shpjegim, për atë mbrojtje të shkëlqyer të atij drafti që ju keni punuar që nuk është e thënë të jetë shterues dhe më i miri, se prandaj do të shkojmë

dhe në Venecia, për këtë punë jemi mbledhur. Dhe pasi të vijë mendimi i Komisionit të Venecias me opinionin final do të ulemi prapë gjithë ditën me Oerdin, me Gentin, me Fatmirin, me Eduardin, se për këtë punë jemi. Po nuk e bëjmë nuk do ta bëjë njeri tjetër. Por ama unë jam ndier shumë mirë, sepse dhe ju jeni bashkë me ekspertët ndërkombëtarë, jeni po aq shqiptarë sa ne, po aq dashamirës sa ne, sepse në fund të fundit të gjithë punojmë për një qëllim. Të bëjmë një sistem drejtësie të pavarur, të pandikuar nga politika, ku të bëhet drejtësi dhe jo të blihet drejtësi, pse jo t'i hapim rrugën këtij vendi pas 25 vjetësh tranzicion. Të bëhemi pjesë e Bashkimit European dhe e popujve të tjerë të qytetëruar të Europës dhe më gjerë.

Ndaj, kërkoj mirëkuptimin e të gjithëve. Ju ftoj që kur të dalim nga kjo sallë dhe ta përcjellim draftin në Komisionin e Venecias, përveç draftit të ekspertëve që e kemi mbi tavolinë dhe që do ta përcjellim andej, t'i marrim të gjitha opinionet, dhe pse jo edhe draftin që keni ju. Ta lexojmë më me qetësi që kur të kthehet drafti nga Komisioni i Venecias të kemi një bazë solide për të filluar një debat profesional dhe teknik për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme. Por nëse do të ndryshohet Kushtetuta për të pasur një reformë në drejtësi ose jo kjo është çështje e vullnetit tërësisht politik dhe është mirë ta dinë shqiptarët. Do ta bëjmë reformën në drejtësi apo nuk do e bëjmë, do të rrimë me këtë sistem, apo do të bëjmë përpjekje për të pasur një sistem tjetër? Por ne si maxhorancë dhe si Parti Socialiste nuk e kemi merakun ta kemi drejtësinë tonën. Drejtësia u takon shqiptarëve dhe ne si politikanë votohemi çdo 4 vjet. Nuk u pëlqejmë ne si qeveri, pas 2 vjetësh kanë mundësinë me votë të lirë, votë të cilën në fakt me ligjin "Për dekriminalizimin" unë dhe Oerdi ua mohuam të drejtën e votës një pjese të shqiptarëve si ne, për atë po e vuajnë dënimin ata, se kështu është rregulli, ne votohemi çdo 4 vjet, nuk i pëlqen Ulsi, vjen tjetri, por për pushtetin gjyqësor shqiptarët nuk e kanë luksin që ta votojnë çdo 4 vjet.

Ndaj merakun ynë është ky. T'u japim shqiptarëve atë që kërkojnë në 25 vjet. Të tjerat pastaj se kush ishte në '97-n, se kush ishte deri në '98-n, se kush ishte deri në 2005-n, se kush ishte deri më 1 janar të 2015-s, për shqiptarët është një kohë që e kanë hedhur mbrapa, një vuajtje që e kanë lënë mbrapa dhe duhet të shohin përpara.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Ristani.

Arben Ristani – Unë do të mundohem të flas shumë shkurt që të mos ju lodh, se dhe problemet dolën. Problemi është se retorika e përfaqësuesve të pushtetit në raport me konsensusin është shumë i mirë. Ndërkohë nga ana tjetër Kryeministri flet për pazare. Ajo që unë mendoj është se në këtë komision ne nuk bëjmë dot as konsensus, as pazare. Unë bashkohem me ato që tha kolegu Halimi, ose kolegu Strazimiri së fundi, që ky komision është në raportet e një postieri, korrieri, apo zyre protokollit. Bën raportin grupi i ekspertëve të maxhorancës, vjen te ne, vjen kjo letra nga kryetari që thotë t'ia përcjellim Komisionit të Venecias dhe ne ia përcjellim. Nuk ka asnjë diskutim për nenet konkrete, asnjë diskutim për zgjidhje konkrete. Është një retorikë nga fillimi në fund dhe kështu nuk bëjmë dot as konsensus as pazare. Nuk bëjmë dot asgjë.

Kështu që e vetmja mundësi që kemi është të themi të paktën 2-3 fjalë të mençura, t'i zgjedhim që dhe ata që na dëgjojnë të kuptojnë se çfarë po ndodh. Duam të bëjmë reformë në drejtësi. Është e nevojshme, është e domosdoshme, është e mirëpritur. Shpresoj të jetë dhe historike, por nuk ma merr mendja se do të jetë. Cilat janë problemet që kemi përpara? Duam një sistem drejtësie që të mos jetë i korruptuar. Duam një sistem drejtësie që jo vetëm të mos jetë i korruptuar, por dhe të na ndihmojë që të luftojmë korrupsionin në shoqërinë shqiptare. Duam një sistem drejtësie që të mos veprojë si korporatë që të mbrohet nga pushtetet e tjera dhe sigurisht duam një sistem drejtësie të mos jetë i kapur nga politika. Ajo që unë gjykoj është se kapja nga politika është një problem kyç. Në rast se sistemi kapet politikisht, rrjedhin vetë pastaj dhe korporativizmi dhe korrupsioni, qoftë brenda, qoftë pamundësia e sistemit për ta luftuar korrupsionin jashtë. Që këtu rrjedh e gjitha, sepse kapja politike cenon një nga shtyllat e sistemit demokratik që ne duam të ndërtojmë, që është ndarja e pushteteve. Nuk mund të ndërtojmë një sistem demokratik pa ndarje pushtetesh. Kapja politike cenon ndarjen e pushteteve. Prandaj nga kjo rrjedhin të gjitha të tjerat. Prandaj dhe ne e kemi më të lehtë të themi që nuk kemi asnjë vërejtje, për sa i përket mënyrës se si do ta luftojmë korrupsionin brenda radhëve të gjyqësorit.

Nuk kemi asnjë vërejtje për mekanizmat që janë zgjedhur në këtë paketë, se si gjyqësori do të luftojë korrupsionin në shoqëri. Nuk kemi asnjë vërejtje për mekanizmat që janë zgjedhur për të luftuar korporativizmin. Por mënyra dhe mekanizmat janë faktorë kyçë që do të zgjedhim për të luftuar kapjen politike. A e kemi sot të kapur sistemin? Sigurisht që e kemi. Të dënosh viktimën dhe të lirosh deputetin me dy kobure që shkon në komisariatit e policisë dhe përdor kobure kundër njerëzve të pambrojtur, është absolutisht kapje politike e sistemit. Të nxjerrësh të

pafajshëm deputetët e maxhorancës që rrahin me grushte deputetët e opozitës në korridoret e Kuvendit dhe të dënosh deputetët e opozitës, sepse thonë mendimin e tyre kundër Kryeministrit është absolutisht sistem i kapur. Sigurisht që e kemi të kapur sistemin.

Por a kapen dhe ekspertët? Sigurisht që kapen dhe ekspertët. Unë kam shumë konsideratë për cilësitë profesionale të ekspertëve, por të sjellësh këtë letër që na sollën sot si gabim në përkthim, kjo është të tallesh me veten dhe të tentosh të tallësh edhe komisionin. Nuk është gabim në përkthim, por është koncept ndryshe, e përpunuar mbi bazën dhe të vërejtjeve që ndoshta të gjithë e kemi marrë që sot, vërejtjet e kryetarit të Gjykatës së Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë. Kanë bërë vërejtje ata. Na ka ardhur që në mëngjes njoftimi për vërejtjet e tyre. Dhe mbasi marrin vërejtjet e tyre rikonceptohet dispozita. Sigurisht është e drejtë ta rikonceptojnë. Shumë mirë bëjnë që e rikonceptojnë, por të mos na e sjellin tani si gabim në përkthim. Kjo është të tallesh. Me kë tallesh? T'ia jap pastaj medias kur të dalim dhe t'ia japim dhe publikut dhe të thonë nëse është gabim ose jo në përkthim. Kështu kapesh, se kthehesh në ushtar pastaj, në qoftë se do të shkosh sipas interesave të atij që të jep urdhër.

E mira do të ishte që pasi erdhi konkluzioni i Komisionit të Venecias ne ta kishim shqyrtuar, t'ju kishim caktuar detyrat e ekspertëve. Mbasi të vinin materialet, t'i kishim diskutuar me njëri-tjetrin. Detyra jonë është t'i japim parlamentit një produkt. Ne do të shohim një draft, një projektligj që do të shtrohet për votim në parlament. Kjo është detyra jonë. Ta bëjmë ne me ndihmën e ekspertëve, por pasi të japim ne detyrat. Erdhi materiali nga Komisioni i Venecias, a u mblodhëm ne? Jo. Ju e dini se opinioni i prokurorëve ka pasur vërejtje të qenësishme ndaj produktit që kanë nxjerrë ekspertët. Po kështu edhe gjykatat. Dhe Gjykata e Krimeve të Rënda sot merr materialin që doli. Kjo tregon se kanë pasur të drejtë se menjëherë u ndryshua. Pra, është vërtet një gjë që duhet ta shohim me kujdes. Nuk e bëni dot historiken me nxitime, me vrap, në rast se vërtet doni të bëni një gjë historike.

Kolegu Bylykbashi tha se do të kërcasë ky material që po punoni, apo ky sistem që doni të miratoni pas 5 ose 10 vjetësh. Vërtet mund të kërcasë, por deri atëherë Rama i ka realizuar qëllimet e veta dhe punë e madhe se kërcet. Por ne nuk duhet të shkojmë me këtë lloj logjike. Në rast se duam të nxjerrim një produkt të mirë, vazhdojmë me këtë mendim që keni për konsensusin e bisedojmë. Halli ynë është vetëm ky, pra, kapja politike. Të gjejmë një formulë që të mos e kapë sistemin zoti Rama sot, as zoti Basha nesër. Ka mundësi që t'i gjejmë formulat. Nuk ka nevojë të shpikim tani. Drejtësia ka 2 mijë vjet që shkruhet dhe përpunohet. I kanë thënë

të tjerët para nesh të gjitha. Nuk do t'i shpikim ne. Ka mekanizma që ta realizojmë, ta bëjmë të mundur që të mos kapet politikisht sistemi. Ose ta zvogëlojmë të paktën në minimum. Kemi mundësi ta bisedojmë. Kaq është e gjitha dhe e gjejmë konsensusin, edhe zoti Majko, se e dëgjova dhe nga Kryeministri derën e referendumit. Nuk shkoni dot me referendum me këto kushte, me këtë ligj që është. Në rast se keni ndër mend të bëni dhe një listë të re për referendumin dhe pastaj të shkoni në referendum, kjo është tjetër histori. Mjaft t'ju themi një gjë, që referendumi të fitojë, do jo më pak se 1/3-n e zgjedhësve në listë që të votojnë pro alternativës së referendumit. Që do të thotë 3 milionë e 300 mijë zgjedhës në listë që do të thotë jo më pak se 1 milion vota pro që të fitojë referendumi. Dhe kjo duhet të jetë 50 plus 1 e pjesëmarrjes që do të thotë se duhet të marrin pjesë jo më pak se 2 milion e ca njerëz. Ju e dini se në zgjedhjet tona na marrin pjesë 1 milion e gjysmë njerëz. Kështu që këto idetë, jo referendum, jo ashtu, jo kështu janë maskime të ballos me maska që doni të bëni akoma. Jemi këtu ku jemi. Të jemi të sinqertë të në atë që bëjmë. Kemi vullnetin t'i japim këtij vendi një produkt të mirë. E kemi 2/3-n të gatshme, sepse thamë se për sa u përket mekanizmave antikorrupsion, antikorporativizëm etj jemi në rregull. Kemi një problem. Që është moskapja e politikës. E gjejmë mekanizmin për ta bërë. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Nuk ka diskutime të tjera, por me sa shoh zoti Halimi do të bëjë një ndërhyrje.

Eduard Halimi – Dua të bëj një ndërhyrje në përfundim të diskutimeve në emër të opozitës.

Në fakt këtu disa deputetë të maxhorancës u ankuan se thanë që nuk na kanë lënë të dalim në televizor, t'u drejtohem qytetarëve, ndaj po drejtohem sot. Në fakt kjo nxjerr pikërisht këtë gjë. Çfarë nxjerr? Nxjerr që ka pasur një urdhër politik. Është e vërtetë. Në studio kemi shkuar ne dhe këtu janë mediat, moderatorët studiove thonë se përfaqësuesit e Partisë Socialiste nuk vijnë nëpër emisione. Ne kemi shkuar vetëm, kjo është e vërteta. Sepse reforma në drejtësi, drafti, gjithçka, procesi duhet të jetë transparent dhe qytetarët duhet ta dinë këtë gjë. I kemi kërkuar ne, ja ku është zoti Devilla, se me sa ngulm kam kërkuar unë zhvillimin e tryezave të rrumbullakëta që i ka bërë dhe e kam përshëndetur.

Pra, procesi duhet të ishte transparent, ndaj dhe ne në drejtim të këtij procesi ne kemi dalë. Por ama ju jeni fshehur pas maskave. Pra, thoni sa mirë që dolën ekspertët se i dëgjuam atje. Pra, fshihemi pas ekspertëve dhe kjo është maskë, nuk shkon, ju nxjerr që gjithçka është

bërë sipas urdhrit politik. E marrim draftin, jua japim këtyre ekspertëve, na i sjellin ata, e nxjerrin dhe pastaj përsëri sot mbrohem pas ekspertëve.

Përtej kësaj sot do të ishte rationale që ne të uleshim dhe të bënim një draft sipas Komisionit të Venecias, konsensus sipas Komisionit të Venecias duhet të ishte baza. Çfarë thotë Venecia? Venecia thotë për shembull që nuk duhet të ndërpriten mandatet e disa institucioneve. Por cili ishte argumenti që na u tha këtu nga zoti Majko? Ai tha se ne ndërprejmë mandatet e disa deputetëve. E nisëm nga vetja, tha ai. Si mund të krahasosh mandatet e prokurorëve me mandatet e trafikantëve të prostitutave të drogës, të cilët u ndërprejnë për shkak të dekriminalizimit? Mund të krahasosh këtu vetëm me alibinë për t'i ikur Venecias se meqenëse ndërprejmë mandatin e një trafikanti prostitutash, e një vrasësi tjetër, e një trafikanti dhe një hajduti ordiner në parlament, meqenëse e bënë për këta do ta bëjnë dhe për prokurorin. Kjo ikje është e turpshme. Nuk duhet ta kishte thënë një gjë të tillë. Nuk mund t'i ikësh dot rekomandimit të Venecias me këtë arsytim, se nuk i iket, të nxjerr keq.

Ndaj dhe duhet t'i rrimë Venecias. Po t'i rrimë Venecias jemi të gjithë të sigurtë me qytetarët dhe tregojmë qëllimin e mirë. Por në qoftë se i ikim Komisionit të Venecias me këtë argument, meqenëse larguam trafikantët dhe tutorët e prostitutave në parlament, hajde të largojmë dhe të ndërpresim mandatet, kjo e nxjerr keq. Unë kështu e shoh. Do të ishte e mundshme dhe një herë. Unë nuk e mora pëlqimin nga kryetari, por mora përgjigjen nga maxhoranca që të kishim një draft. Drafti që paraqesin ekspertët sot është një draft i njëanshëm. Kjo nuk ka dyshime të gjithë e dimë. Nuk është një draft i cili të ishte bashkë me ekspertë të opozitës. Drafti është i hartuar në mënyrë jotransparente. E dimë, është i qartë, i njohur publikisht që nuk është bërë transparent. Drafti nuk bazohet në konsensus të plotë. Kjo është e qartë dhe besoj se jemi të qartë të gjithë. Drafti nuk bazohet në konsensus, sipas Komisionit të Venecias.

Ndaj dhe ne kemi vërejtjet tona, të cilat kanë qenë pjesë e diskutimeve të sotme të të gjithë kolegëve dhe që kanë të bëjnë vetëm me shqetësimet e ngritura për skemën në mënyrën se si kërkohet të ndërtohet një skemë e re dhe si kërkohet të mbipopullohet e gjitha kjo skemë e cila çon në atë rekomandim, rekomandimin 55 të Komisionit të Venecias që është kapja. Se për ato çështje që i shohim ne, që maxhorancës nuk i pëlqejnë në këtë draft, thonë se ka një opion tjetër. Ta pyesim dhe një herë Komisionin e Venecias se mos ndoshta ndërro mendje. Mos ndoshta mos e ka pasur me 3/5-tat dhe 2/3-tat? Po ai nuk e ndërro mendjen. Për ato pjesë që kanë të

bëjnë me çështje që nuk i pëlqejnë maxhorancës, që nuk duan të lexojnë, nuk i kanë rënë në ballë për hir të së vërtetës. Këtu thonë që ka dhe një opsion tjetër. Hajde ta pyesim dhe një herë Komisionin e Venecias se ndoshta ndërron mendje. Kjo nuk shkon. Çfarë themi ne? Ne themi të kemi një konsensus sipas Venecias dhe jo pazare. Se ju e dini që nuk i kishit në zgjedhjet e 23 qershorit 84 vota, por kishit 83 vota. As 88 vota nuk i kishit. Çfarë bëtë? Bëtë pazar. Për çfarë ju duhej ky pazar juve? Çfarë i kushtoi ky pazar Ramës për të blerë deputetë lart e poshtë? I duhej për të ardhur në këtë ditë sot. Pra, nëpërmjet votave të blera në parlament, të krijonte një supermaxhorancë sot dhe t'u thoshte: "Prit se unë kam votat". Atëherë, kjo maxhorancë ka pazarin, të cilin nuk e kishte. Merrni dhe lexoni rezultatin e 23 qershorit! I kishit? Jo, nuk i kishit. Pa folur më pas për deputetët me rekorde kriminale e me radhë, gjë që e trajtuan kolegët, por nuk i kishit dhe e bëtë me pazar. Votat i keni me pazar. Ndaj për të ikur nga ky pazar, duhet të shkojmë te standardi, i cili është Venecia. Standardi që thotë Venecia është: "Kur ke 71, duhet që emërimet të bëhen me më shumë se 71, me 84 vota. Kur ke 84 vota, duhet t'i bësh me 94 vota". Këtë thotë Venecia, për t'i ikur këtij pazarit që është sot parlamenti, por edhe një mundësie për të bërë pazar sërish nesër. Ne këtu kemi kaluar shumë pazare dhe e dimë sesi luajnë dhe blihen deputetët.

Pra, për t'u ikur këtyre pazareve, duhet të shkojmë te standardi i Venecias dhe, në qoftë se ikim nga këtu, shkojmë prapë te pazaret. Ky është konsensusi?

Në fund të fjalës sime, duke pasur parasysh se nuk ka një konsensus, sipas Venecias, që të kemi një draft unik për t'ia ofruar asaj, ekspertët e opozitës do të paraqesin brenda ditës së hënë të gjitha vërejtjet që ata kanë, të cilat dolën sot nga diskutimet e kolegëve. Pra, ditën e hënë do t'ia paraqesim komisionit dhe Kryetarit të Kuvendit në mënyrë që t'i dërgohen Komisionit të Venecias së bashku me draftin e njëanshëm të hartuar nga ekspertët tuaj.

Proceduralisht, në fund të projektvendimit të paraqitur për t'u miratuar, pas pikës 1 të shtohet edhe një pikë tjetër 2, e cila t'i paraqesë Komisionit të Venecias edhe opinionin e opozitës, që do të depozitohet brenda ditës së hënë në orarin zyrtar. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se nuk ka diskutime të tjera.

Në cilësinë e anëtarit dhe të drejtuesit të këtij komisioni më takon të jap disa konsiderata në lidhje me çështjet që po diskutojmë, si edhe për atë se çfarë do të vendosim.

Së pari, më duhet të them se kam një vlerësim pozitiv në tërësi për debatin e sotëm. Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë kolegët si ata në të majtën time, ashtu edhe ata në të djathtë, për debatin e moderuar dhe konstruktiv që u zhvillua.

Dy gjëra janë të dallueshme në përmbledhjen e këtij debati.

Së pari, të gjithë ne biem dakord dhe shprehim vullnetin e të gjitha forcave politike që përfaqësojmë, vullnetin tonë si ligjvënës se reforma në drejtësi është themelore për procesin e integritetit, por mbi të gjitha për demokracinë në Shqipëri, për shtetin e së drejtës dhe për qytetarët e Shqipërisë. Kjo është shumë e rëndësishme.

Së dyti, biem dakord me çfarë u kuptua, projekti i paraqitur, është një projekt që ka një bazament të shëndetshëm, me të cilin të gjithë ndajmë shumë pika të përbashkëta, por me rezervën se kemi edhe këndvështrime të ndryshme për çështje të veçanta të trajtuara nga ky projekt nga pikëpamja e leximit që u është bërë rekomandimeve të Komisionit të Venecias, këtij institucioni prestigjioz, të cilit iu drejtuam për të marrë vlerësimet, sugjerimet dhe rekomandimet përkatëse, thënë pak më shkurt për të bërë arbitrin në këto rrethana.

Të dyja këto, qoftë vullneti, qoftë pikat e mëdha të përbashkëta, janë një bazament shumë i rëndësishëm me të cilin ne do të mund të vazhdojmë një dialog për të gjetur një konsensus shumë më të gjerë sesa ky që kemi sot. Është shumë pozitiv fakti që opozita, ashtu siç i kuptova unë, besoj se i kam kuptuar drejt, kishte tre çështje themelore, të cilat i tha kolegu Halimi.

E para, ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit brenda sistemit.

E dyta, me efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e sistemit në raport me dukuritë korruptive në shoqëri.

E treta, me çështjen e kapjes politike të sistemit.

Dy çështjet e para, në vlerësimin edhe të kolegëve të opozitës, janë trajtuar dhe kanë mirëkuptim përgjithësisht për zgjidhjet që janë dhënë këtu në projekt. Natyrisht, kemi këndvështrime të ndryshme për disa aspekte dhe për mënyrën sesi e shohim çështjen e tretë, por mendoj se është një hap para i rëndësishëm fakti që vullneti është i përbashkët. Shumë zgjidhje janë të dakordësuara dhe kanë mbështetje, pra mbetet që të kemi zgjidhje edhe për çështjet e tjera, jo ndarjet, por këndvështrimet e ndryshme, me aq sa unë kuptova. Ne mund të gjejmë një emërues të përbashkët, sepse është i domosdoshëm për të pasur mbështetje parlamentare të projektit, si dhe për të pasur mbështetje politike dhe institucionale. Ky projekt që në thelb është i

rëndësishëm dhe ka të bëjë me një nga reformat më të mëdha që ka kaluar ky vend në këta 25 vjet, ka të bëjë me një reformë që prek një pushtet të rëndësishëm, siç është pushteti i drejtësisë; ka të bëjë me një reformë që, para se të jetë një parakusht për të hyrë në BE, është një kusht që ka të bëjë me funksionimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri, është një detyrim, është një borxh i madh që ne ua kemi qytetarëve të këtij vendi, të cilët meritojnë të kenë një drejtësi të pavarur, të ndershme dhe profesionale, një drejtësi që t'i gjykojë ata në mënyrë të barabartë, një drejtësi që të gjykojë në mënyrë të drejtë në respekt të Kushtetutës dhe të ligjit, si zyrtarin, ashtu edhe qytetarin, si politikanin e lartë, ashtu edhe njeriun e thjeshtë.

Kjo është një domosdoshmëri me të cilën ne duhet të përballemi. Projekti u ka dhënë zgjidhje shumë çështjeve, që do ta bënin këtë drejtësi shumë më funksionale. U shtrua këtu një çështje që ka të bëjë me procesin. Po pse kjo është rruga? Zotërinj, duhet të jemi të qartë për këtë gjë që në nisje, që në gjenezë të këtij procesi, sepse ai ka nisur si një proces i mbështetur fort në ekspertizë, në atë vendase dhe ndërkombëtare. E kemi përshëndetur së bashku nevojën e ekspertizës së Bashkimit Europian, nevojën e ekspertizës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sot ne po shohim produktin e kësaj ekspertize, po shohim një projekt që është brenda standardeve më të mira europiane dhe më gjerë të kësaj fushe. Pse është konceptuar si i tillë? Dakord, më gjeni një ligj që bëhet në parlament, që diskutohet, votohet, që ulemi dhe e bëjmë ne dhe po ne e diskutojmë dhe e votojmë. Të gjitha ligjet në këtë parlament i bëjnë ekspertët, si eksperti i qeverisë apo eksperti i parlamentit, kur ka iniciativa parlamentare, dhe politika ulet dhe diskuton për të pasur vullnetet përkatëse për përmbajtjen, për substancën e projektit, jo më kur bëhet fjalë për Kushtetutën, jo më kur bëhet fjalë për një reformë të këtyre përmasave në lidhje me ndryshimet thelbësore të Kushtetutës, si dhe ndryshimin e gati rreth 30 ligjeve të ndryshme, të cilat do ta shoqërojnë atë për ta bërë të zbatueshme. Si mund të bëhet pa ekspertë dhe pa ekspertizë? Ku janë ekspertët dhe ku është politika? Është një çështje që diskutohet dhe është e drejtë. Ne kemi nisur një proces ku ekspertiza ka bërë një analizë dhe mbi atë është ndërtuar një strategji. Mbi analizën dhe strategjinë ka filluar një projekt kushtetues i bashkëshoqëruar me disa projekte të tjera amendimesh ligjore. Në një moment të caktuar ne të gjithë thamë: “Prit, se përveç ekspertizës që kemi futur brenda në grupin e madh të ekspertëve, ne kemi nevojë edhe për një ekspertizë tjetër, e cila na ka asistuar në bërjen e Kushtetutës, për Komisionin e Venecias”. Atëherë, produkti me shumë të drejtë, u gjykua që t'i kalohej Komisionit të Venecias.

Komisioni i Venecias, me një dashamirësi të jashtëzakonshme, e shqyrtoi në një kohë jo të zakonshme për procedurat se si operon dhe sollti një dokument paraprak me vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse. Ne themi se ky dokument e mbështet dhe e vlerëson produktin që kishin bërë ekspertët. Natyrisht ka gjëra që duhen riparë, gjë që është pranuar edhe nga vetë ekspertët në përfundim të procesit të konsultimeve në një dalje publike të zotit Kraja. Për këtë arsye e çuam në Venecia. Kur erdhën rekomandimet përkatëse, ishte detyrimi i atyre që e kërkuan këtë mendim që të bënë reflektimet e nevojshme. Tani është momenti për t'ua rikthyer atyre që bënë rekomandimet dhe për t'u thënë nëse i kemi kuptuar drejt këto që na keni thënë ju. A ka gjëra që shkojnë në të njëjtën logjikë, në të njëjtën arsyetim dhe me të njëjtin standard që ju keni parashikuar këtu? Nëse ata do të thonë: “Po, këto janë”, unë besoj se puna e ekspertëve është e përfunduar. Por nëse ata do të thonë: “Jo kështu, këtë nuk e kemi kuptuar drejt dhe do të duhej që ta kuptonit kështu”, pa dyshim do të reflektohet nga opinioni i tyre final në zgjidhjen finale të ekspertëve.

Do të më pyesin: ku është dialogu politik këtu?

E para, gjithë kjo që ne bëjmë pa dyshim që është dialog politik, i cili formalizohet, por do të vijë një moment që, pasi të kemi një projekt në tavolinë, do të thuhet: “Për ne standardi është ky dhe brenda këtij standardi”, këtë e thotë edhe sot Venecia për disa zgjidhje “u mbetet autoriteteve vendase për të vendosur”. Edhe kjo edhe ajo janë të pranueshme dhe këtë le ta vendosin autoritetet shqiptare, le ta vendosë ligjvënësi shqiptar. Këtu do të fillojë një diskutim, pra në fazën e tretë, i kësaj tavoline, që është një tavolinë thellësisht politike, duke gjykuar brenda atyre që na kanë thënë, se nuk e ndryshojmë dot se është standard ndërkombëtar dhe ne kemi rënë dakord për ta respektuar këtë standard. Kjo është diçka shumë pozitive dhe ne nuk do ta prekim. Na kanë thënë: “Shiheni se kjo ka nevojë, mund të jetë edhe për ne këtu si standard, por mbetet në vullnetin tuaj.” Ne do ta diskutojmë dhe do të vendosim më pas për t'ia çuar parlamentit shqiptar. Pa dyshim, besoj unë, duke gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme dhe kjo si rrjedhojë e një dialogu politik në bashkëpunim përsëri me ekspertët për zgjidhjet teknike, duke na çuar në atë që quhet “zgjidhje konsensuale”. Kjo dallon nga ti atë dhe unë këtë, por nga ajo që mbështetet në zgjidhjen racionale kushtetuese, ligjore dhe të argumentuar. Kjo është diferenca dhe ne këtë po kërkojmë të bëjmë në këtë proces.

Unë mendoj se kemi bërë mirë që kemi menduar për ta bërë në këtë proces, por dua të jem i hapur. Ka gjëra, të cilat janë të diskutueshme dhe nuk bëj ndonjë herezi po të them se ka

disa gjëra që mund të ishin ndryshe, kjo është mëse e arsyeshme dhe normale të kesh një këndvështrim tjetër, sepse secili nga ne, që është në këtë tavolinë dhe jashtë kësaj tavoline, mund të ketë zgjidhje të caktuara dhe kjo është më se e pranueshme, është e logjikshme. Këtë do të diskutojmë, këtë do të debatojmë edhe në vijim.

Dua të ndalem te një çështje, të cilën ju u munduat ta trajtonit gjerë e gjatë, si dhe mendoni se kjo është pikërisht ajo që na ndan thellësisht. Ju folët për një tentativë të Partisë Socialiste, të Kryeministrit Rama për të kapur drejtësinë.

Zotërinj, sapo jua tha kolegu që ishte në këtë tavolinë: “Ju jeni 62 apo 65 vetë, numri nuk ka rëndësi, por si mund ta kapë një forcë politike që ka 62 mandate shifrën 84?”. Jemi duke folur për numrin 84 dhe ne kemi vetëm 62. Meqë numri 84 quhet pazar, pse nuk është edhe numri 94 pazar, sipas kësaj logjike? Çfarë kemi sot ne? Ne sot kemi një gjë që është paradoksale. Dyshemeja për të votuar një gjyqtar të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe gjithë sistemin e drejtësisë është 36 vota.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një sekondë. Çfarë kërkon projekti?

E para, një pjesë e mirë e tyre të mos hyjnë fare në aulën parlamentare për vendimmarrje dhe kjo është diçka e madhe, është hap i jashtëzakonshëm përpara, por edhe ata që do të hyjnë për një vendimmarrje në respekt të balancës dhe kontrollit ndërmjet pushteteve të votohen me 84 vota. Shikoni se çfarë ndryshimi! Është hequr një pjesë e madhe e institucioneve të drejtësisë që nuk do të kalojnë më nga përzgjedhja, kontrolli dhe votimi politik. Ata pak që do të mbeten, do t'i nënshtrohen jo më një dyshemeje me 36 vota, por një kuorumi me 84 vota dhe ky është një hap i madh përpara dhe i jashtëzakonshëm me atë që ishte. Me kaq e latë. T'i thërrasim edhe pak kujtesës. Ne që jemi përballë në këtë tavolinë, në vitin 2012 kemi sjell në këtë sallë një projekt. A e dini se cili ishte thelbi i atij projekti? Ai projekt, të cilin ne e sollëm kur ishim në opozitë, parashikonte së paku 1/3, përjashto Vetting-un, të cilin nuk e kishim në ato momente, por edhe si koncept për të qenë i sinqertë, e këtyre ndryshimeve. Një nga kërkesat themelore të atij projekti, për të cilin unë kam qenë bashkautor i iniciativës, parashikonte votimin me 3/5. Gjyqi i atij projekti është bërë në këtë sallë, duke na thënë se “jeni të marrë, po kërkonti 85-s, kërkonti ta bllokoni, kërkonti ta kapni, kërkonti që ta bëni pazar politik” e të tjera. Ne numrin 85 kërkuam dhe na u quajt herezi politike. Pse e bëmë ne atë, sepse ishim në opozitë? Ne e bëmë

në mënyrë që edhe ju, edhe ne kur të ishim në opozitë të gjenim një konsensus sa më të gjerë mundësisht. Ndërsa sot na thuhet 94.

Pra, 94 deri vitin që vjen, pas këtij viti që mund të ndryshojë, të shohim sesi do ta bëjmë. Pra, logjika juaj, kur i keni 84 vota duhet bërë 94 vota, kur ju i keni 71 vota duhet bërë 84 vota. Po përse Kushtetutë sezonale do të jetë kjo, Kushtetutë për verë dhe Kushtetutë për dimër? Ka një koherencë. Presidenti i Republikës do të zgjidhet, këtë e kemi bërë bashkërisht, unë jam këtu, për fat të mirë, nuk kam qenë mbështetës i kësaj, megjithatë kjo nuk do të thotë gjë, kam qenë në atë parlament dhe pjesë e mëkatit jam. Pra, e bëmë nga 84 vota në 71 vota për Presidentin e Republikës. Çfarë do të bëjmë tani? Një noter që të shkojë në Këshillin e Lartë Gjyqësor duhet të marrë 84 vota, ndërsa që të zgjidhet një President duhet të marrë 71 vota. Kjo nuk bën sens. A keni të drejtë ju në shqetësimin se mund të ndodhë ky fenomen? Po. Ky është ndryshimi midis meje dhe teje, zotëri, këtu. Unë e pranoj, ka diçka që duhet rregulluar, por logjika që të ketë dy Kushtetuta, logjika që për institucione të ndryshme të ketë kuorume të ndryshme, kjo nuk më bën sens. A kam unë një zgjidhje? Jo, nuk e kam një zgjidhje sesi me 3/5 apo me 71 mbase, t'i votojmë në parlament, por që të mos kenë mundësi për t'u kapur. A keni një zgjidhje?

Na është thënë se do të sillni disa propozime. Unë kam qenë së bashku me zotin Bylykbashi në një tavolinë, ku kemi qenë të ftuar, dhe në praninë e dy njerëzve shumë të respektuar, të nderuar dhe me një kontribut të jashtëzakonshëm në procesin e reformës në drejtësi, të ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zotit Donald Lu dhe të ambasadores së Bashkimit Europian, zonjën Romana Blautin, në pritje të një zgjidhjeje, na ishte thënë një variant 3/5-at plus. Sot e kësaj dite ne ende nuk kemi një propozim konkret 2/3-at ose rashë e vdiqa. Mund të ketë edhe 71, por nuk e kap, mund të ketë edhe 3/5-at, po prapë nuk e kap. Ju nuk bëni gjë tjetër veçse ngrini dhe ulni shembullin e Hungarisë.

Kolegë të dashur,

Lexojeni mirë rastin e Hungarisë! Merreni opinionin e Venecias të Hungarisë dhe lexojeni! A e dini pse është kritikuar në atë rast Hungaria? Pse maxhoranca e asaj kohe ligjet fiskale i ngriti në fuqinë e dy të tretave, në mënyrë që kushdo që të vinte më mbrapa të mos kishte mundësinë të ndryshonte për të përfituar interesa të caktuara. Ligjet e thjeshta i bëri me kuorum të përforcuar në mënyrë që askush të mos prekë interesat e tyre financiare. Është një

logjikë krejt e kundërt nga ajo që po diskutojmë sot. Unë nuk besoj se Venecia ka parasysht këtë, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...kanë thënë që super maxhorancat kanë nevojë për kontroll. A jemi supermaxhorancë? Jo, nuk ka një supermaxhorancë, madje për maxhorancën tonë ju vetë thoni: “Ekziston, nuk ekziston, nuk merren vesh, po ndahen, po divorcohen, pa bashkohen”. Çfarë do të bëjmë ne me 85 vota, kur ju nga mëngjesi deri në darkë thoni: “Jeni të divorcuar”? Si mundet? Kjo nuk është logjikë. Ne e mbështesim këtë si maxhorancë, sepse mendojmë se është një zgjidhje e arsyeshme në Kushtetutën aktuale. A mund të gjejmë zgjidhje të tjera? Jemi të hapur, por nuk kemi dëgjuar zgjidhje të tjera. Kjo e bën jo fort të besueshme të gjithë këtë retorikë politike. Unë nuk i largohem mendimit se të dy palët, të gjithë çfarë jemi këtu, ne dhe ata që janë të thirrur në rolin e ekspertëve që mund të na ndihmojnë dhe janë duke na ndihmuar në këtë proces, duhet të gjejmë zgjidhje që të mos ketë as kapje politike. Jam dakord, absolutisht. Kjo nuk është një Kushtetutë që bëhet për ne sot, apo do të bëhet për ju nesër. Nga jeta ime politike e gjatë në këtë parlament, të gjithë ata që kanë tentuar të bëjnë ligje në interes të tyre gjatë një maxhorance, ato ligje u kanë lidhur edhe këmbën, edhe kokën kur kanë ikur nga maxhoranca. Absolutisht, po. Ne duhet të gjejmë zgjidhje të arsyeshme. Duhet të flasim me propozime konkrete.

Ky është një proces, nuk është i lehtë. Jam dakord me kolegun tim Halimi, që nuk është një proces i lehtë. Sinqerisht, jam mbështetës në aspektin që kjo do të prodhojë pa dyshim edhe debat, debat të arsyeshëm, përplasje të ideve dhe të projekteve. Kjo është përsëri e pranueshme, por shumë e rëndësishme është të jemi të qartë se ku duam të shkojmë. Ku duhet të shkojmë në interes, për të dhënë një projekt kushtetues që shkon me frymën tërësore të Kushtetutës me standardet ndërkombëtare të bazuara tashmë në vlerësimet përkatëse që bën Komisioni i Venecias nën një ekspertizë të fortë vendase dhe ndërkombëtare. Për fat të mirë e kemi dhe duhet t’u themi faleminderit për gjithë këtë punë të madhe që kanë bërë, me qëllimin final për të ndryshuar këtë sistem, që të jetë nga një sistem në shërbim të një grupi njerëzish, në një sistem që të jetë në shërbim të qytetarëve të këtij vendi. Janë pozitive hapat që kemi bërë, u konfiguruan këtu qartazi edhe në këtë debat. Ka pika siç u tha, që të mos i përsërisim më, janë këndvështrime, mendoj unë, të ndryshme të asaj që thotë Venecia dhe të projektit që është bërë.

Për këtë arsye zgjidhja që i dhamë është një zgjidhje e pranueshme në kushtet konkrete. Ajo që lexoi zoti Halimi është e pranueshme edhe prej meje. Unë propozoj ta votojmë.

Po, zoti Halimi. Një fjali, ju lutem!

Eduard Halimi - Kjo nuk është zgjidhje e pranueshme. Kjo është e keqja më e vogël, siç thonë edhe ata. Të jemi të sinqertë me palët. Zgjidhja do të ishte ky dialog politik, i cili duhet të bazohet në sinqeritet. Këtë që bëmë sot ne duhet ta kishim bërë në dhjetor, kur erdhi raporti i Venecias.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të kishit bërë dy, tre, katër.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Eduard Halimi - Pastaj t' u thoshim ekspertëve: “Uluni të gjithë bashkë!”. Të mos ishin vetëm ekspertët tuaj, por të ishin edhe tanët dhe të ulëshin bashkë. Shqetësimet që kemi ne, t'i kishin implementuar dhe të vinin me një draft. Ajo ishte zgjidhja racionale, një zgjidhje që do të ishte me konsensus, bazuar te Venecia. Jo një zgjidhje që po ecim përsëri: ju keni draftin tuaj, ju si PS, keni tuajin, ata si LSI kanë të tyrin, ne po bëjmë tjetër. Këtu konsensus mbi standardet nuk ka. Kjo do të jetë zgjidhja e koordinuar për shkak se nuk ka konsensus bazuar mbi standarde. Ju doni t'i ikni Venecias dhe po arrijmë këtu.

Fatmir Xhafaj - Biem dakord me propozimin që u bë? Kush është dakord?

Dakord.

Faleminderit!

Spartak Braho – Meqenëse ju nuk gjetët rast të nënvizonit edhe faktin që Lëvizja Socialiste për Integrim ka një opinion...

Fatmir Xhafaj - E thamë këtë.

Spartak Braho - Një minutë!

Kjo duhet të nënvizohet këtu në projektvendim. Ky projektvendim ka nevojë të korrigjohet: “Mbledhja vendosi t'i paraqesë Komisionit të Venecias kërkesën për opinion lidhur me tekstin e rishikuar të projektamendamenteve kushtetuese të propozuara nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë së bashku me opinionet e tjera”.

Fatmir Xhafaj – Po.

Spartak Braho – Jo, këtë e shtova unë tani.

Fatmir Xhafaj – Dakord, sipas propozimit tuaj.

Spartak Braho – Pika e dytë; “Komisioni i Posaçëm Parlamentar të vazhdojë veprimtarinë dhe dialogun sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias”.

Jeni dakord? Në bazë të një kalendari.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Të kalojnë të gjitha opinionet e grupeve parlamentare.

Gent Strazimiri - Mbi këto parime që vendosëm tani këtu, besoj që edhe zoti Braho edhe zoti Halimi të jenë pjesë e formulimit të vendimit ose të zbardhjes së vendimit që vendosëm këtu, sepse praktikisht në këtë mënyrë siç po sillemi dhe siç vendosëm në këtë tryezë, drafti i ashtuquajtur i ekspertëve të nivelit të lartë, ngelet vetëm drafti i PS-së. LSI-ja ka një draft të vetin, PD-ja ka një draft të vetin.

Fatmir Xhafaj – E thamë.

Spartak Braho - Sa për sqarim, ne nuk kemi draft. Ne kemi një opinion. Ashtu sikurse edhe ju nuk paraqitët një draft, keni një opinion.

Fatmir Xhafaj- “T”i paraqesë Komisionit të Venecias kërkesën për opinion lidhur me tekstin e rishikuar të projektamendamenteve kushtetuese të propozuara nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, së bashku me opinionin e grupeve politike parlamentare...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...të opozitës dhe të LSI-së.”

Dakord.

Faleminderit!

Punë të mbarë

Fundjavë të mbarë!

Falenderoj ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë për kontributin dhe për prezencën!

Mirë u takofshim!

Mbyllet mbledhja.

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë